



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 9

Tiranë – E martë, 3 shkurt 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 77, datë 28.1.2015	Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor..... 211
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 2, datë 26.1.2015	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshme me Kushtetutën, të vendimeve nr. 1714, datë 5.6.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; nr. 10- 2009-648 (305), datë 16.7.2009 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe vendimin nr. 00-2012-1189, datë 25.5.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë..... 224
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 3, datë 26.1.2015	Me objekt: - Shfuqizimi, si të papajtueshme me Kushtetutën, i vendimeve nr. 971, datë 20.7.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 00-2012-245, datë 8.2.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi). -Dërgimi i çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë..... 229

**VENDIM****Nr. 77, datë 28.1.2015****PËR KONTRIBUTET E DETYRUESHME
DHE PËRFITIMET NGA SISTEMI I
SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE
SIGURIMI I KUJDESIT SHËNDETËSOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë”, të ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve të nëntokës” dhe të ligjit nr. 9136, datë 1.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. KATEGORITË E PERSONAVE TË MBROJTUR DHE TË DETYRUAR PËR TË SIGURUAR, SIPAS DEGËVE E SKEMAVE TË SIGURIMIT**

Konsiderohen të mbrojtur dhe përfitojnë të ardhura e shërbime nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë:

1. Personat që zhvillojnë aktivitet ekonomik dhe kanë plotësuar moshën e punës, sipas përcaktimeve në Kodin e Punës, si më poshtë vijon:

a) Të punësuarit me mandat kushtetues, të punësuarit e emëruar, të punësuarit me kontratë pune pa afat ose me afat më shumë se një muaj, që punojnë me kohë të plotë ose të pjesshme, për 87 (tetëdhjetë e shtatë) orë në muaj e më shumë, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme, por jo më pak se niveli minimal, për degën e sigurimit të sëmundjeve, të barrë lindjes, të pensioneve, të aksidenteve në punë e sëmundjeve profesionale, të papunësisë dhe për sigurimin e kujdesit shëndetësor;

b) Të punësuarit me kontratë pune me ose pa afat, që punojnë me kohë të pjesshme, që zgjat më pak se 87 (tetëdhjetë e shtatë) orë në muaj, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme, por jo më pak se niveli minimal, për degën e barrë lindjes, pensioneve, aksidenteve në punë e sëmundjeve profesionale dhe për sigurimin e kujdesit shëndetësor;

c) Të punësuarit me kontratë pune, me kohë të plotë ose të pjesshme ditore, që zgjat më pak se 7 (shtatë) ditë kalendarike radhazi në vit, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme për degën e aksidenteve në punë e sëmundjeve profesionale dhe për sigurimin e kujdesit shëndetësor;

ç) Pronarët e personave juridikë, që ushtrojnë funksione drejtuese në shoqëri, si administratorë apo çdo funksion tjetër, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme, sipas përcaktimeve në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1, të këtij vendimi;

d) Të vetëpunësuarit me statusin e personit fizik, që ushtrojnë veprimtari ekonomike, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme, jo më pak se niveli minimal, për degën e barrë lindjes, pensioneve dhe për sigurimin e kujdesit shëndetësor;

dh) Pjesëtarët e familjes, që punojnë e bashkëjetojnë ligjërisht me të vetëpunësuarin, person fizik, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme, jo më pak se niveli minimal, për degën e barrë lindjes, pensioneve dhe për sigurimin e kujdesit shëndetësor;

e) Personat fizikë, të vetëpunësuar në veprimtari tregtare apo shërbimi, ambulantë, që kanë mbushur moshën 16 vjeç, që nuk janë të siguruar si punëmarrës ose si të vetëpunësuar në veprimtari ekonomike të vijueshme, që paguajnë kontribute të



detyrueshme për degën e pensioneve dhe për sigurimin e kujdesit shëndetësor. Si persona të vetëpunësuar në veprimtari tregtare apo shërbimi dhe ambulantë konsiderohen personat që vetëpunësohen në veprimtari:

i) të përkohshme e të vijueshme, por pa një vendqëndrim apo shërbim të përcaktuar;

ii) të përkohshme e me ndërprerje gjatë javës, por pa një vendqëndrim apo shërbim të përcaktuar;

iii) të vijueshme, në veprimtari tregtare në tezgë, pa vendqëndrim të përhershëm ose në mjete që lëvizin;

iv) të vijueshme, në veprimtari transporti, me ndërprerje gjatë javës.

e) Personat e punësuar, që punojnë me kohë të plotë apo të pjesshme pune, si punëtorë shtëpie në familjet e të tjerëve, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme për degën e pensioneve dhe për sigurimin e kujdesit shëndetësor. Konsiderohen “punëtorë shtëpie” personat që punësohen nga kryefamiljari, në punë të tilla si, kujdestar për fëmijët, kuzhinier, pastrues, roje-administrator shtëpie, asistent për të moshuarit, etj., apo edhe shërbime të ndryshme të kësaj natyre;

f) Nxënësit e shkollave të mesme apo profesionale, si edhe studentët, për kohën e programuar të praktikës mësimore dhe praktikave profesionale pa pagesë, për të cilët paguhen kontribute nga punëdhënësi, në nivelin minimal, vetëm për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, për aq kohë sa është përcaktuar në kontratën e lidhur ndërmjet subjektit dhe institucionit përgjegjës;

g) Personat e punësuar për herë të parë, në subjekte të cilat zhvillojnë aktivitete ekonomike sipas Regjimit të Përpunimit Aktiv (fason), për një periudhë deri në tre muaj të formimit profesional, për një profesion të caktuar, të kualifikuar, që sigurohen në mënyrë të detyrueshme, në nivel minimal, vetëm në degën e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale, me kushtin që subjekti punëdhënës nuk përfiton financime nga programet e nxitjes së punësimit nëpërmjet formimit profesional;

gj) Personat e punësuar në dy ose më shumë subjekte juridike ose fizike, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme, për degën e sigurimit të sëmundjeve, barrë lindjes, pensioneve, aksidenteve në punë e sëmundjeve profesionale, papunësisë dhe për sigurimin e kujdesit shëndetësor;

h) Personi fizik që, njëkohësisht, zhvillon aktivitet ekonomik si anëtar i papaguar i familjes, si edhe anëtar i papaguar i familjes, që zhvillon aktivitet ekonomik në dy persona fizikë, me të cilët bashkëjeton, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme për degën e sigurimit të barrë lindjeve dhe pensioneve dhe për sigurimet e kujdesit shëndetësor;

i) Personat e punësuar për më shumë se 87 orë në muaj, në rast sëmundjeje ose kujdesjes për fëmijën në ngarkim, të vërtetuara me raport mjekësor për deri në 14 ditët e para, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme. Përlllogaritja e kontributeve të sigurimeve shoqërore, të sigurimit të kujdesit shëndetësor, si dhe tatimi mbi të ardhurat nga punësimi, zbatohet njëllë, ashtu si për të ardhurat nga puna, pavarësisht se mënyra e llogaritjes së tyre i referohet dispozitave të veçanta të Kodit të Punës;

j) Të vetëpunësuarit në bujqësi, të aftë për punë, që kanë mbushur moshën 16 vjeç, deri në moshën për pension, sipas nenit 92, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kur:

i) nuk janë të siguruar nga punësimi në sektorë të tjerë, banojnë në të njëjtin rreth ku kanë tokën në pronësi ose në përdorim dhe zhvillojnë veprimtari bujqësore e blegtorale, që paguajnë kontribute në mënyrë të detyrueshme për barrë lindje, për pensione dhe për sigurimin e kujdesit shëndetësor;

ii) nuk janë të siguruar nga punësimi në sektorë të tjerë, banojnë në fshat dhe zhvillojnë veprimtari bujqësore e blegtorale, edhe nëse kanë tokë në pronësi ose në përdorim, me vendndodhje në rrethin fqinj, që paguajnë kontribute në mënyrë të detyrueshme për barrë lindje, për pensione dhe për sigurimin e kujdesit shëndetësor.

2. Personat me mandat kushtetues, të punësuarit e emëruar dhe personat e tjerë që trajtohen nga skemat e sigurimeve shoqërore suplementare, ushtarakët e Forcave të Armatosura, punonjësit e Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri, personat me tituj shkencorë, profesorë, asistentë profesorë, drejtues kërkimesh dhe mjeshtër kërkimesh, të cilët derdhin kontribut suplementar të detyrueshëm, për përfitimin e pensionit suplementar.



3. Personat e punësuar në miniera, në nëntokë, të cilët paguajnë kontribute të detyrueshme shtesë për degën e pensioneve.

4. Personat me banim të përhershëm në Shqipëri, me të ardhura të rregullta nga pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, të cilët paguajnë kontribute të detyrueshme vetëm për sigurimin e kujdesit shëndetësor. Në këtë rast, kontributi i detyrueshëm zbatohet vetëm kur personi me të ardhura të rregullta nga pronësia nuk ka sigurim tjetër të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor.

5. Të papunët, që përfitojnë pagesë papunësie për periudhën që trajtohen me këtë pagesë, për të cilët buxheti i shtetit derdh kontribute për degën e pensioneve dhe për barrë lindje.

6. Personat nën pagesë kalimtare apo pension të parakohshëm, sipas dispozitave të ligjeve nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, ish-punonjësit që kanë punuar në miniera, në nëntokë, dhe ish-punonjësit e industrisë ushtarake, që përfitojnë trajtim financiar të veçantë, personat që u shërbejnë invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe gratë, që dalin në pension për periudhën e kryerjes së arsimit të lartë, të cilët sigurohen, në mënyrë të detyrueshme, nga buxheti i shtetit, vetëm në degën e pensioneve.

7. Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, të punësuar, punëdhënës ose të vetëpunësuar në subjekte të regjistruara për efekte fiskale në Republikën e Shqipërisë, mbrohen dhe sigurohen, në mënyrë të detyrueshme, sipas përcaktimeve në pikën “1”, të këtij kreu.

8. Nga mbrojtja dhe siguri i detyrueshëm shoqëror përjashtohen shtetasit e huaj që:

a) punojnë në subjekte të huaja, të cilat, në bazë të një marrëveshjeje, nuk kanë detyrimin për t’u regjistruar në organet tatimore shqiptare;

b) janë të punësuar në subjekte të huaja, që nuk kanë detyrimin për t’u regjistruar në organet tatimore shqiptare, të cilët vijnë në Shqipëri të

punojnë në një punë apo shërbim të kualifikuar, sipas një kontrate shërbimi, të lidhur me një subjekt të regjistruar në organet tatimore shqiptare, i cili nuk është degë apo njësi e subjektit kontraktor. Zgjatja e kohës së qëndrimit dhe shërbimit është sipas përcaktimeve në ligjin nr. 108/2013 “Për të huajt”;

c) janë të punësuar në subjekte të huaja, të cilat nuk kanë detyrimin për t’u regjistruar në organet tatimore shqiptare, të cilët dërgohen në Shqipëri të punojnë në një punë apo shërbim të caktuar, sipas një kontrate të lidhur nga subjekti i huaj punëdhënës me një subjekt të regjistruar në organet tatimore shqiptare, i cili nuk është degë apo njësi e subjektit kontraktor, kur plotësohen kushtet, si më poshtë vijon:

i) Të ketë një marrëveshje për shmangien e taksimit të dyfishtë, të lidhur midis shtetit shqiptar dhe shtetit të subjektit punëdhënës të huaj;

ii) Procedura e regjistrimit, leja e punës dhe kohëzgjatja e saj të jenë kryer në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”;

iii) Rezidenca dhe detyrimet për pagesë, sipas legjislacionit fiskal, të zbatohen sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9920, datë 9.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

iv) Subjekti kontraktues, i regjistruar në organet tatimore shqiptare, kërkon çdo 3 muaj, nga subjekti punëdhënës i huaj, dokument të konfirmuar nga strukturat e sigurimeve shoqërore të shtetit përkatës lidhur me pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore, të shoqëruar me listën emërore të punonjësve të huaj, të cilën e administron së bashku me dokumentet e transfertave në favor të punëdhënësit të huaj.

ç) me rezidencë e banim të përhershëm jashtë territorit të Shqipërisë, të cilët kanë veprimtari të regjistruara në emrin e tyre në të dyja shtetet ku kryejnë detyrën e administratorit, së bashku me një administrator tjetër, me rezidencë të përhershme në Shqipëri. Në këtë rast, personat do të jenë subjekt i mbrojtjes dhe i sigurimit të detyrueshëm shoqëror në atë shtet ku kanë rezidencën dhe, njëkohësisht, të vërtetojnë me dokument mbrojtjen me sigurim shoqëror nga shteti përkatës. Rezidenca e ka kuptimin sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9920, datë 9.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

d) që janë të përjashtuar nga pagimi i kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe të



sigurimit të kujdesit shëndetësor në Shqipëri, në bazë të një marrëveshjeje të lidhur midis shtetit të tyre me shtetin shqiptar.

9. Përjashtohen nga pagesa e kontributeve të detyrueshme të sigurimit të kujdesit shëndetësor personat ekonomikisht aktivë, që nuk janë me banim të përhershëm në Shqipëri, që janë të punësuar, të vetëpunësuar, punonjës të papaguar të familjes dhe personat me të ardhura të rregullta nga pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme dhe burime të tjera të krahasueshme.

II. PAGA PËR EFEKT TË LLOGARITJES SË KONTRIBUTEVE

1. Paga bruto, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore e të kujdesit shëndetësor, është paga e caktuar sipas legjislacionit në fuqi, ose në kontratën e punës, sipas rastit, me kohë ose vëllim pune dhe shtesat e tjera, me karakter të përhershëm, që lindin nga marrëdhëniet e punës. Paga bruto evidentohet në listëpagesën tip, e cila është deklarata për pagesë dhe dokumenti bazë për evidentimin e kontributeve individuale.

2. Në pagën bruto, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe sigurimin e kujdesit shëndetësor, nuk përfshihen:

a) përfitimet që punëmarrësi merr nga fondet e sigurimeve shoqërore;

b) kompensimet nga rritja e çmimeve;

c) dhuratat në të holla, që nuk kanë karakter të përhershëm dhe të përgjithshëm;

ç) të ardhurat nga detyrimi ushqimor, të caktuara me vendim gjykatë;

d) vlera e antidoteve, që punëdhënësi jep në natyrë, për personat e punësuar, sipas legjislacionit në fuqi;

dh) shpërblimet me karakter jo të përhershëm, të lejuara në mbështetje të legjislacionit në fuqi, shpërblimet nga fondi i veçantë, për rastet e fatkeqësive në familje, për sëmundjet e gjata, për dëme, në raste fatkeqësive të mëdha natyrore, dhe për veprimtari të shquara;

e) vlera e shpenzimeve për të punësuarit, që kryejnë veprimtari jashtë qendrës së banimit, të cilat jepen bazuar në legjislacionin në fuqi dhe që nuk janë pjesë e pagës;

ë) honorarët apo shpërblimet e tjera të kësaj natyre, që nuk kanë lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës.

3. Paga bruto mujore, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve shoqërore, nga data

1.1.2015 e në vazhdim, të jetë, si më poshtë vijon:

a) jo më pak se sa paga minimale mujore, e barabartë me 22 000 (njëzet e dy mijë) lekë dhe deri në 97 030 (nëntëdhjetë e shtatë mijë e tridhjetë) lekë, për personat e punësuar;

b) jo më pak se sa paga minimale, e barabartë me 22 000 (njëzet e dy mijë) lekë dhe sipas përcaktimit të vetë personit, deri 97 030 (nëntëdhjetë e shtatë mijë e tridhjetë) lekë, për personat e vetëpunësuar;

c) e barabartë me pagën minimale mujore prej 22 000 (njëzet e dy mijë) lekësh, për punonjësit e papaguar të familjes.

4. Paga mujore, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimit të kujdesit shëndetësor, nga data 1.1.2015 e në vazhdim, të jetë, si më poshtë vijon:

a) jo më pak se sa paga minimale, e barabartë me 22 000 (njëzet e dy mijë) lekë dhe deri në shumën e pagës bruto, sipas deklaratës së listëpagesës, për personat e punësuar;

b) sa dyfishi i pagës minimale, e barabartë me 44 000 (dyzet e katër mijë) lekë, për personat e vetëpunësuar dhe punonjësit e papaguar të familjes me të cilët i vetëpunësuari punon e bashkëjeton ligjërisht;

c) paga minimale mujore, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimit të kujdesit shëndetësor, për personat e vetëpunësuar në bujqësi, është 4 620 (katër mijë e gjashtëqind e njëzet) lekë.

5. Paga mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve suplementare të detyrueshme, të jetë nga 22 000 (njëzet e dy mijë) lekë e deri në shumën e pagës bruto, sipas listëpagesës.

6. Paga mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve shtesë të punonjësve që punojnë në miniera, në nëntokë, është sipas pikës 3, të këtij kreu.

7. Paga mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të buxhetit të shtetit, për kohën e trajtimit me pagesë kalimtare apo pension të parakohshëm të personave që kryenin funksione kushtetuese apo si punonjës të lartë të shtetit dhe për ish-ushtarakët, punonjësit e Policisë së Shtetit, të Shërbimit Informativ, të Gardës së Republikës, të Policisë së Burgjeve e Mbrojtjes nga Zjarri dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm është e barabartë me pagën referuese, sipas gradës dhe funksionit, në momentin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës.



8. Paga mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të buxhetit të shtetit për personat që përfitojnë pagesë papunësie, për ish-punonjësit që kanë punuar në miniera, në nëntokë, dhe ish-punonjësit e industrisë ushtarake, që përfitojnë trajtim financiar të veçantë, personat që u shërbejnë invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe gratë që dalin në pension për periudhën e kryerjes së arsimit të lartë, është e barabartë me pagën minimale.

III. LLOJET, SHUMA DHE SHPËRNDARJA E KONTRIBUTEVE

Llojet, shpërndarja sipas degëve e skemave të sigurimit dhe masa e kontributeve, nga data 1.1.2015 e në vazhdim, janë, si më poshtë:

1. Shuma minimale mujore e kontributeve i referohet pagës minimale dhe normës së kontributit. Kontributi minimal mujor, sipas degëve dhe skemave të sigurimit, është 6 138 (gjashtë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë) lekë dhe ndahet, si më poshtë:

N/r	Emërtimi	norma në %	shuma në lekë
I	Totali i kontributit të sigurimit shoqëror	24.50	5 390
1	Dega e sigurimit të sëmundjeve	0.30	66
2	Dega e sigurimit të barrë lindjeve	1.40	308
3	Dega e sigurimit të pensioneve	21.60	4 752
4	Dega e sigurimit të aksidenteve	0.30	66
5	Dega e sigurimit të papunësisë	0.90	198
II	Kontributi i sigurimit të kujdesit shëndetësor	3.40	748
	Gjithsej	27.90	6 138

2. Shuma minimale mujore e kontributit të sigurimit të kujdesit shëndetësor për të vetëpunësuarit dhe punonjësit e papaguar të familjes, me përjashtim të të vetëpunësuarve në bujqësi, të jetë 3.4% e dyfishit të pagës minimale mujore, të përcaktuar për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimit të kujdesit shëndetësor, e barabartë me 1 496 (një mijë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë.

3. Kontributi i detyrueshëm për të punësuarit me kontratë pune, që zgjat më shumë se 87 orë në muaj, të jetë:

a) për sigurimet shoqërore, 24.5% të pagës bruto, sipas listëpagesës, ku pjesa e punëdhënësit të jetë 15.0% dhe pjesa e të punësuarit 9.5%, por jo më pak se paga minimale dhe jo më shumë se paga maksimale, e përcaktuar në këtë vendim, për efekt të llogaritjes së kontributeve shoqërore;

b) për sigurimin e kujdesit shëndetësor, 3.4% të pagës bruto, sipas listëpagesës, ku pjesa e punëdhënësit të jetë 1.7% dhe pjesa e të punësuarit 1.7%, por jo më pak se paga minimale, e përcaktuar në këtë vendim, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimit të kujdesit shëndetësor.

4. Kontributi i detyrueshëm për të punësuarit me kontratë pune, që zgjat më pak se 87 orë në muaj, të jetë:

a) për sigurimet shoqërore, 23.3% të pagës bruto, sipas listëpagesës, ku pjesa e punëdhënësit të jetë 13.9% dhe pjesa e të punësuarit 9.4%, por jo më pak se paga minimale dhe jo më shumë se paga maksimale, e përcaktuar në këtë vendim, për efekt të llogaritjes së kontributeve shoqërore;

b) për sigurimin e kujdesit shëndetësor, 3.4% të pagës bruto, sipas listëpagesës, ku pjesa e punëdhënësit të jetë 1.7% dhe pjesa e të punësuarit 1.7%, por jo më pak se paga minimale e përcaktuar në këtë vendim, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimit të kujdesit shëndetësor.

5. Kontributi i detyrueshëm, për të punësuarit me kontratë pune që zgjat më pak se 1 javë, të jetë:

a) për sigurimet shoqërore, 0.3% të pagës bruto, të realizuar gjatë ditëve të punës dhe përballohet nga punëdhënësi;

b) për sigurimin e kujdesit shëndetësor, 3.4% të pagës bruto, të realizuar gjatë ditëve të punës, ku pjesa e punëdhënësit të jetë 1.7% dhe pjesa e të punësuarit 1.7%.

6. I vetëpunësuarit dhe i vetëpunësuarit që punëson të tretë, me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi, të paguajë për vete një kontribut të detyrueshëm për sigurimet shoqërore, në masën 23% të pagës, por jo më pak se paga minimale mujore dhe sipas përcaktimit të vetë



personit, deri në nivelin e pagës maksimale për efekt të kontributeve shoqërore.

7. I vetëpunësuar dhe i vetëpunësuar që punëson të tretë, me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi, të paguajë për vete një kontribut të detyrueshëm për sigurimin e kujdesit shëndetësor, në masën 3.4% të dyfishit të pagës minimale mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve, e barabartë me 1 496 (një mijë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë në muaj.

8. I vetëpunësuar, për pjesëtarët e familjes së tij, që nuk trajtohen me pagë, por që punojnë e bashkëjetojnë me të ligjërish, me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi, të paguajë kontribut të detyrueshëm për sigurimet shoqërore, në masën 23% të pagës mujore minimale prej 22 000 (njëzet e dy mijë) lekësh, e barabartë me 5 060 (pesë mijë e gjashtëdhjetë) lekë në muaj.

9. I vetëpunësuar, për pjesëtarët e familjes së tij, që nuk trajtohen me pagë, por që punojnë e bashkëjetojnë me të ligjërish, me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi, të paguajë një kontribut të detyrueshëm për sigurimin e kujdesit shëndetësor, në masën 3.4% të dyfishit të pagës minimale mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve, e barabartë me 1 496 (një mijë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë në muaj.

10. Personat mbi moshën 18 vjeç, me të ardhura të rregullta nga pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, që nuk kane sigurim tjetër të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, të paguajnë një kontribut të detyrueshëm për sigurimet shëndetësore, në masën 3.4% të dyfishit të pagës minimale mujore, e barabartë me 1 496 (një mijë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë në muaj.

11. Kontributi i detyrueshëm për aksidente në punë dhe sëmundje profesionale, për kohën e formimit profesional, të personave të punësuar në subjekte që zhvillojnë veprimtari ekonomike sipas Regjimit të Përpunimit Aktiv (fason), të jetë 0.3% e pagës bruto minimale, e barabartë me 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë në muaj dhe paguhet totalisht nga punëdhënësi.

12. Për nxënësit e shkollave, të mesme apo profesionale, dhe studentët, për kohën e programuar të praktikës mësimore, kontributi i detyrueshëm për aksidente në punë dhe sëmundje profesionale të jetë 0.3% e pagës bruto minimale, e barabartë me 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë në muaj. Kontributet paguhet nga subjekti ku kryhet

praktika dhe për atë kohë sa është përcaktuar në kontratën e lidhur ndërmjet tij dhe institucionit përgjegjës ose nga institucioni përgjegjës.

13. Personat e vetëpunësuar në veprimtari tregtare apo shërbimi, ambulante, të deklarojnë dhe të paguajnë kontribut minimal mujor në shumën 4 246 (katër mijë e dyqind e dyzet e gjashtë) lekë, nga të cilat 2 750 (dy mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë për sigurime shoqërore dhe 1 496 (një mijë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë për sigurimin e kujdesit shëndetësor.

14. Për personat që punojnë si punëtorë shtëpie, punëdhënësi të deklarojë dhe të paguajë kontribut minimal mujor në shumën 3 498 (tre mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë, nga të cilat 2 750 (dy mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë për sigurime shoqërore dhe 748 (shtatëqind e dyzet e tetë) lekë për sigurimin e kujdesit shëndetësor.

15. Llogaritja dhe deklarimi i kontributeve mujore, për personat që janë ekonomikisht aktivë në më shumë se një subjekt juridik ose fizik, bëhet, si më poshtë:

a) Kur i njëjti person është ekonomikisht aktiv në dy ose më shumë subjekte dhe në secilin prej tyre merr pagë më të lartë se paga minimale, llogaritja e kontributit të sigurimit shoqëror dhe sigurimit të kujdesit shëndetësor është e detyrueshme për çdo subjekt. Në këtë rast, llogaritja e kontributit të sigurimit të kujdesit shëndetësor bëhet sipas pagës përkatëse, që merr nga secili subjekt, ndërsa masa e llogaritur e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në total, të jetë jo më shumë se kontributi i llogaritur mbi pagën maksimale;

b) Kur i njëjti person është ekonomikisht aktiv në dy ose më shumë subjekte, dhe në njërin prej tyre paga është më e vogël se paga minimale, llogaritja e kontributit të sigurimit shoqëror dhe sigurimit të kujdesit shëndetësor është e detyrueshme për çdo subjekt. Në këtë rast, llogaritja e kontributit të sigurimit të kujdesit shëndetësor bëhet sipas pagës përkatëse, që merr nga secili subjekt, ndërsa llogaritja për kontributet e sigurimeve shoqërore, në total, të jetë jo më shumë se kontributi i llogaritur mbi pagën maksimale;

c) Kur i njëjti person, për shkak të natyrës së punës si punonjës pastrimi, punonjës mirëmbajtjeje, lulishtar, e të tjerë të kësaj natyre, është i punësuar në dy ose më shumë subjekte, me orar të reduktuar gjatë ditës dhe puna e kryer në



secilin subjekt llogaritet më e vogël se niveli i pagës minimale, njëri nga subjektet, në marrëveshje me punëmarrësin dhe me të tjerët, konsiderohet si punëdhënësi bazë, i cili merr detyrimin për deklarimin e punonjësit si dhe deklarimin e pagesën e kontributeve të detyrueshme. Puna e kryer tek punëdhënësit e tjerë dokumentohet në një kontratë shërbimi, të lidhur midis palëve, ndërsa paga e përgjithshme, për efekt të kontributeve, nuk mund të jetë më e vogël se paga minimale;

c) Kur një person fizik i vetëpunësuar punon edhe si anëtar i papaguar i familjes ose një familjar punon në dy persona fizikë, që janë familjarë të tij, kontributet llogariten e paguhen në nivelin minimal, pavarësisht se janë ekonomikisht aktive në dy subjekte;

d) Rregullat e llogaritjes, të deklarimit, përjashtimet dhe rimbursimit të kontributeve të paguara më tepër se detyrimet ligjore, përcaktohen me udhëzim të ministrit të Financave.

16. Të vetëpunësuarit në bujqësi të derdhin kontribut vjetor, për sigurimet shoqërore, në masën 33 000 (tridhjetë e tre mijë) lekë, me përjashtim të të vetëpunësuarve, që banojnë në rrethet Bulqizë, Dibër, Gramsh, Has, Kolonjë, Kukës, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tepelenë dhe Tropojë, për të cilët masa e kontributit vjetor është 25 300 (njëzet e pesë mijë e treqind) lekë.

17. Të vetëpunësuarit në bujqësi të derdhin kontribut mujor, për sigurimin e kujdesit shëndetësor, në masën 3.4% të dyfishit të pagës minimale mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimit të kujdesit shëndetësor, të barabartë me një vlerë prej 314 (treqind e katërmëdhjetë) lekë në muaj.

18. Për personat me mandat kushtetues, të punësuarit e emëruar dhe personat e tjerë që trajtohen nga skemat e sigurimeve shoqërore suplementare, të cilët derdhin kontribute për pension suplementar, janë, si më poshtë vijon:

a) Punonjësit që kryejnë funksione kushtetuese, punonjësit e lartë të shtetit, sipas funksioneve, në masën 5, 4, dhe 3 % të pagës bruto;

b) Usharakët e Forcave të Armatosura, punonjësit e Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe punonjësit e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në masën 5% të pagës bruto;

c) Personat që kanë titullin shkencor “Profesor”, “Drejtnes kërkimesh”, “Profesor i asociuar”, “Mjeshtër kërkimesh”, kur punojnë në universitetet, shkollat e larta dhe Akademinë e Shkencave, në Republikën e Shqipërisë, në masën 5% të pagës bruto, ndërsa, kur këta persona punojnë në universitete private, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, në masën 7 % të pagës bruto.

19. Personat e punësuar në miniera, në nëntokë, të cilët paguajnë kontribute të detyrueshme shtesë, për degën e pensioneve, në masën 5% të pagës mbi të cilën llogaritet kontributi i detyrueshëm i sigurimit shoqëror, nga e cila 3% përballohet nga punëdhënësi dhe 2% nga punëmarrësi.

20. Për të papunët, që përfitojnë pagesë papunësie, për periudhën që trajtohen me këtë pagesë, buxheti i shtetit derdh kontribute për degën e pensioneve dhe për barrë lindje, në masën 23% të pagës minimale.

21. Për ish-punonjësit që kanë punuar në miniera, në nëntokë, dhe ish-punonjësit e industrisë ushtarake, që përfitojnë trajtim financiar të veçantë, personat që u shërbejnë invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe gratë, që dalin në pension për periudhën e kryerjes së arsimit të lartë, buxheti i shtetit derdh kontribute, për degën e pensioneve, në masën 21.6% të pagës minimale.

22. Për personat që kryejnë funksione kushtetuese si dhe punonjësit e lartë të shtetit, për ish-ushtarakët, punonjësit e Policisë së Shtetit, të Shërbimit Informativ, të Gardës së Republikës, të Policisë së Burgjeve e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, gjatë kohës së trajtimit me pagesë kalimtare ose pension të parakohshëm, buxheti i shtetit derdh kontribute, për degën e pensioneve, në masën 21.6% të pagës mesatare referuese, sipas gradës dhe funksionit, të indeksuar çdo vit me koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësuar.

IV. REGJISTRIMI DHE EVIDENTIMI I KONTRIBUTEVE

1. Subjektet juridikë e fizikë, edhe për efekt të deklarimit të pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe të sigurimit të kujdesit shëndetësor, regjistrohen në organet tatimore, sipas përcaktimit në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Kryefamiljarët, që punësojnë persona si punëtorë shtëpie, i rregullojnë marrëdhëniet e



punës nëpërmjet një kontrate me shkrim ndërmjet palëve, ku, veç të tjerave, shënohen, detyrimisht, numri personal i identifikimit të personit të punësuar, koha e fillimit të punës, zgjatja e saj “me ose pa afat”, si dhe paga mujore bruto. Në këtë rast, kryefamiljari përcaktohet në rolin e punëdhënësit dhe, si i tillë, ka detyrimin për regjistrim në organet tatimore dhe për pajisjen, nga këto organe, me numrin e identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT-in).

3. Regjistrimi dhe çregjistrimi nga organet tatimore, i kryefamiljarëve që punësojnë persona si punëtorë shtëpie dhe i personave të vetëpunësuar në veprimtari tregtare, shërbimi apo ambulantë, bëhet sipas një procedure të thjeshtuar, që përcaktohet me udhëzim nga ministri i Financave.

4. Formimi profesional nëpërmjet punës, sipas përcaktimeve në kreun I, realizohet nga punëdhënësi që zhvillon aktivitet ekonomik, sipas Regjimit të Përpunimit Aktiv (fason). Koha e formimit profesional të personit, për një profesion të caktuar të kualifikuar, mund të zgjatë deri në tre muaj gjithsej dhe vetëm një herë, pavarësisht nga subjektet ku është kryer. Lista e personave pjesëmarrës, periudha e formimit profesional dhe profesioni për të cilin do të kualifikohen deklarohet zyrtarisht nga subjekti, në zyrën përkatëse të punësimit, përpara fillimit të trajnimit. Zyra e punësimit bën evidentimin në një regjistër të veçantë dhe autorizon subjektin për vazhdimin e procesit dhe deklarimin në organet tatimore.

5. Punëdhënësi bën sigurimin e punëmarrësit, duke filluar nga data e fillimit të punës, sipas përcaktimit në kontratën e punës apo në aktin e emërimit dhe vazhdon të paguajë kontribute çdo muaj, gjatë të gjithë kohës që vazhdojnë marrëdhëniet e punës.

6. Kur fillimi dhe ndërprerja përfundimtare e marrëdhënieve të punës bëhen gjatë muajit, si dhe kur gjatë muajit ka ndërprerje të përkohshme, për shkak të përfitimeve afatshkurtra nga skema e sigurimeve shoqërore, kontributet llogariten e paguhen në bazë të pagës së realizuar gjatë ditëve të punës.

7. Punëdhënësit dhe të vetëpunësuarit e kryejnë deklarimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe të sigurimit të kujdesit shëndetësor në total dhe për çdo person, në formë elektronike, në sistemin informatik të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, e cila siguron edhe mbajtjen elektronike

të të dhënave të kontributeve të deklaruara nga subjekti, të pagesave të kryera, si dhe të detyrimeve që lindin nga vlerësimet dhe mospagesat.

8. Të vetëpunësuarit në bujqësi regjistrohen në organet e sigurimeve shoqërore pas paraqitjes së këtyre dokumenteve:

a) certifikatës familjare të gjendjes civile;

b) vërtetimin e pronësisë mbi tokën, lëshuar nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, pranë organeve të pushtetit vendor, dhe/ose

c) vërtetimin mbi tokën e marrë në përdorim, lëshuar nga strukturat përkatëse, pranë organeve të pushtetit vendor, dhe/ose

ç) kontratën e qiramarrjes së tokës bujqësore, të noterizuar;

d) vërtetimin e lëshuar nga komuna ose bashkia, ku cilësohet se personi ushtron veprimtari bujqësore/blektorale.

9. Të vetëpunësuarit në bujqësi i paguajnë kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe të sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor individualisht, një herë në tre muaj. Afati i pagesës së kontributeve është jo më vonë se dita e fundit e muajit të tretë, brenda çdo tremujori kalendarik.

10. Të vetëpunësuarit në bujqësi, të cilët nuk arrijnë të plotësojnë kushtin minimal të periudhës së sigurimit, për të përfutur pension mund të kryejnë pagesa kontributesh edhe pas plotësimit të moshës për pension, por me kusht që ato t'u korrespondojnë periudhave para plotësimit të moshës për pension dhe për këto periudha do të paguhet sipas masës së kontributit të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, për vitin kur kryhet pagesa.

11. Të vetëpunësuarit në bujqësi paguajnë kontributet për sigurimet shoqërore dhe për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, për vitin 2015 e në vazhdim, pavarësisht se mund të jenë të pasiguruar për vitet pararendëse. Periudhat për të cilat nuk janë paguar kontributet nuk njihen periudha sigurimi.

12. Të vetëpunësuarit në bujqësi, të cilët nuk i kanë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore për periudhat e kaluara, por që i kanë patur kushtet për t'u siguruar si të vetëpunësuar në bujqësi, pavarësisht nga vendbanimi aktual, mund t'i paguajnë kontributet për këto periudha, sipas masës së kontributit, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, për vitin kur kryhet pagesa.



13. Nuk është i detyrueshëm sigurimi dhe nuk mund të llogariten detyrimet e kontributeve e të kamatëvonesave për pjesëtarët e familjeve bujqësore, për periudhën që përfitojnë ndihmë ekonomike, sipas ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmat dhe shërbimet shoqërore”. Periudhat, për të cilat nuk janë paguar kontributet, nuk njihen periudha sigurimi.

14. Për efekt të përfitimeve afatshkurtra nga sigurimet shoqërore dhe të përfitimeve të shërbimeve nga sigurimi i kujdesit shëndetësor, vlerësohen të siguruar për tremujorin pasardhës:

a) të vetëpunësuarit, pjesëtarët e papaguar të familjes, të vetëpunësuarit në veprimtari ambulante, nëse i kanë paguar kontributet e tremujorit pararendës brenda datës 20 të muajit pasardhës, pas mbarimit të tremujorit;

b) punëmarrësit e punësuar tek i vetëpunësuarit, i cili ka statusin “i vetëpunësuar me punëmarrës”, nëse i kanë paguar kontributet e tremujorit pararendës përpara lindjes së të drejtës për përfitime;

c) të vetëpunësuarit në bujqësi, nëse i kanë paguar kontributet e tremujorit pararendës jo më vonë se dita e fundit e muajit të tretë, brenda çdo tremujori kalendarik;

ç) Këta persona, përpara fillimit të trajtimit me përfitime, paguajnë kontributet e tremujorit në vazhdim, nga dita e parë dhe deri në ditën kur lind e drejta e përfitimit.

15. Kontributi vullnetar llogaritet në kufijtë e pagës minimale dhe maksimale, të caktuar nga Këshilli i Ministrave, dhe paguhet nga personi i siguruar në afatin e përcaktuar në kontratën e sigurimit vullnetar.

16. Kontributet e buxhetit të shtetit, për të papunët që përfitojnë pagesë papunësie, për ish-punonjësit që kanë punuar në miniera, në nëntokë, dhe ish-punonjësit e industrisë ushtarake, që përfitojnë trajtim financiar të veçantë, personat që u shërbejnë invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, për gratë që dalin në pension për periudhën e kryerjes së arsimit të lartë, për personat që kanë kryer funksione kushtetuese dhe si ish-punonjës të lartë të shtetit dhe për ish-ushtarakët, punonjësit e Policisë së Shtetit, të Shërbimit Informativ Shtetëror, të Gardës së Republikës, të Policisë së Burgjeve e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shërbimit, të Kontrollit të Brendshëm, gjatë kohës së trajtimit me pagesë kalimtare ose pension të

parakohshëm, derdhen çdo muaj, nga buxheti i shtetit në Fondin e Sigurimeve Shoqërore. Procedurat e llogaritjes dhe të pagesës përcaktohen me udhëzim të ministrit të Financave.

17. Kontributet e llogaritura dhe të derdhura evidentohen në bazën e të dhënave, të krijuar për këtë qëllim. Instituti i Sigurimeve Shoqërore evidenton kontributet individuale të personave të siguruar sipas numrit personal i identifikimit. Kontributet për shtetasit e huaj evidentohen sipas numrit të sigurimit dhe, në rastet kur nuk ekziston, të përdoret numri personal i identifikimit që personi ka në pasaportë. Procedurat e evidentimit, dokumentacioni bazë dhe kontrolli i saktësisë së mbartjes së të dhënave, nga dokumentet bazë në kartelat individuale të kontributeve, përcaktohet me rregullore të miratuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

18. Libreza e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe sigurimit të kujdesit shëndetësor është dokumenti me të cilin pajiset çdo kontributpagues, që evidenton kontributet e paguara dhe shërben si dokument bazë individual për realizimin e së drejtës për përfitime e shërbime. Instituti i Sigurimeve Shoqërore realizon prodhimin dhe plotëson kërkesat e punëdhënësve dhe të vetëpunësuarve me librezat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, kundrejt pagesës së çmimit nga ana e tyre.

19. Personat juridikë punëdhënës pajisin të punësuarit me librezën e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe i plotësojnë ato çdo muaj, në datën e pagesës së pagës mujore.

20. Për të vetëpunësuarit dhe pjesëtarët e familjes, për punëmarrësit e punësuar tek i vetëpunësuarit, që ka statusin “i vetëpunësuar me punëmarrës”, për personat e vetëpunësuar në veprimtari tregtare apo shërbimi, ambulantë, për personat e vetëpunësuar në bujqësi, si dhe për personat e siguruar vullnetarisht, libreza e kontributeve plotësohet dhe vërtetohet nga strukturat lokale të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

V. PROCEDURAT E KALIMIT TË KONTRIBUTEVE DHE MBLEDHJA E BORXHEVE

1. Kontributet, gjobat dhe interesat e lidhura me to, paguhet nga punëdhënësit dhe nga të vetëpunësuarit në llogaritë bankare të përcaktuara



për këtë qëllim, të çelura në bankat e nivelit të dytë, apo edhe nëpërmjet “Postës Shqiptare”, sh.a, për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, e cila është përgjegjëse për administrimin e këtyre llogarive, si për të gjitha llogaritë e tjera, për të ardhurat tatimore. Dokument bazë për pagesën e tyre është urdhërpagesa e printuar nga sistemi informatik, bazuar në deklaratën e listëpagesës, njoftimin e vlerësimit për detyrimet dhe çdo dokument tjetër ligjor, i miratuar për këtë qëllim.

2. Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe të sigurimit të kujdesit shëndetësor, për personat e punësuar si punëtorë shtëpie, paguhen nga kryefamiljari, i përcaktuar si punëdhënës, në bankat e nivelit të dytë, sipas procedurave të vendosura për këtë qëllim. Pagesa e kontributeve bëhet çdo tre muaj, sipas rregullave për pagesat e kontributeve nga personat e vetëpunësuar në biznesin e vogël.

3. Bankat e nivelit të dytë, në fund të çdo dite, raportojnë në mënyrë të hollësishme në Bankën e Shqipërisë dhe në organet tatimore lëvizjen dhe gjendjen progresive të llogarive për kontributet e paguara për sigurimet shoqërore dhe sigurimet e kujdesit shëndetësor. Për gjendjen e këtyre llogarive njoftohet Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit dhe, nëpërmjet saj, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Procedurat e evidentimit, të njoftimit dhe të kalimit të kontributeve në llogaritë e Fondit të Sigurimeve Shoqërore dhe në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor përcaktohen me udhëzim të ministrit të Financave.

4. Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe të sigurimeve të kujdesit shëndetësor nga të vetëpunësuarit në bujqësi dhe të siguruarit në mënyrë vullnetare paguhen në llogaritë bankare apo në zyrat e “Postës Shqiptare”, sh.a., sipas marrëveshjeve, ndërmjet tyre, dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Instituti i Sigurimeve Shoqërore është përgjegjës për administrimin e tyre.

5. Për personat e vetëpunësuar në bujqësi, shuma e detyrimit kontributiv dhe e kamatëvonesave llogaritet nga organet e sigurimeve shoqërore. Dokument bazë për llogaritjen dhe evidentimin e tij është akt-detyrimi tip, i cili plotësohet nga organet e sigurimeve shoqërore, jo më vonë se tre muaj nga kalimi i afatit ligjor për pagesën e kontributeve ose, përfundimisht, në datën e pagesës së kontributeve. Shuma e

detyrimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe kamatëvonesat evidentohet në kontabilitetin e sigurimeve shoqërore, sipas procedurave të miratuara nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

6. Kontributet vullnetare të sigurimeve të kujdesit shëndetësor paguhen në llogaritë bankare të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

7. Kontributet e papaguara në afatet e përcaktuara, dhe interesat e lidhura me to, vlerësohen detyrim ndaj Fondit të Sigurimeve Shoqërore dhe Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, sipas përkatësisë.

VI. SHKËMBIMI I INFORMACIONIT PËR KONTRIBUTET DHE PAGESAT

1. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, bazuar në procedurën e komunikimit on-line midis sistemeve informatike, të ngritura nga institucionet, dërgon:

a) Në Institutin e Sigurimeve Shoqërore:

i) Deklaratën e listëpagesës me të dhënat përmbledhëse të saj, sipas të gjitha rubrikave, për çdo NIPT;

ii) Shumat e kontributeve dhe interesave, të derdhura sipas NIPT-eve, muajve dhe bankën ku është bërë derdhja;

iii) Listëpagesat për çdo NIPT, me të dhënat sipas të gjitha rubrikave, për çdo person, të identifikuar edhe me numrin personal, shuma e kontributeve e të cilave është derdhur plotësisht;

iv) Të dhënat e mësipërme transmetohen edhe për çdo version të fundit të listëpagesës;

v) Listën e subjekteve aktivë me të dhënat identifikuese dhe numrin e punonjësve.

Të dhënat e mësipërme dërgohen në komunikim on-line, midis sistemeve informatike të ngritura në të dy institucionet. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore hartojnë marrëveshjet dhe protokollet e përbashkëta të shkëmbimeve elektronike.

b) Në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor:

i) Deklaratën e listëpagesës me të dhënat përmbledhëse të saj, sipas të gjitha rubrikave, për çdo NIPT;

ii) Shumat e kontributeve dhe interesave të derdhura sipas NIPT-eve, muajve dhe bankën ku është bërë derdhja;

iii) Listëpagesat për çdo NIPT, me të dhënat sipas të gjitha rubrikave, për çdo person të



identifikuar edhe me numrin personal, shuma e kontributeve e të cilave është derdhur plotësisht;

iv) Të dhënat e mësipërme transmetohen edhe për çdo version të fundit të listëpagesës;

v) Listën e subjekteve aktivë, me të dhënat identifikuese dhe numrin e punonjësve.

Të dhënat e mësipërme dërgohen në komunikim on-line midis sistemeve informatike të ngritura në të dy institucionet. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Fondi i Sigurimit Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor hartojnë marrëveshjet dhe protokollet e përbashkëta të shkëmbimeve elektronike.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dërgon në Institutin e Statistikave (INSTAT), të dhënat statistikore për numrin e subjekteve të regjistruara dhe numrin e kontribuesve, sipas veprimtarisë që ushtrojnë.

3. Strukturat në varësi të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dërgojnë në strukturat përkatëse të sigurimeve shëndetësore, zyrtarisht dhe në format elektronik, të dhënat për kontributet e sigurimeve shëndetësore dhe interesat e paguara nga personat e vetëpunësuar në bujqësi, deri në datën 10 të muajit pasardhës të muajit kur është derdhur kontributi.

4. Kur nuk ka të dhëna, për shkak të mosdorëzimit nga tatimpaguesit të deklarave të listëpagesave, administrimi bëhet në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

VII. BAZA E VLERËSUAR

Shuma mujore e përfitimeve varet nga baza e vlerësueshme dhe periudha e sigurimit.

1. Baza e vlerësuar mesatare mujore, për efekt të llogaritjes së përfitimit, është e barabartë me pagën bruto mujore mbi të cilën janë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore për periudhën, pjesëtuar me shumën e muajve të periudhës së përcaktuar.

2. Baza e vlerësuar mujore neto do të jetë shuma që del pasi nga baza e vlerësuar e çdo muaji zbritet tatimi mbi të ardhurat nga puna, shuma e kontributit të sigurimeve shoqërore, të sigurimit të kujdesit shëndetësor dhe të sigurimit suplementar të detyrueshëm, që zbritet nga paga e punonjësit, sipas dispozitave në fuqi.

3. Baza e vlerësuar mesatare mujore neto, për llogaritjen e përfitimeve për sëmundje, barrëllindje, dhe për të ardhura të tjera afatshkurtra, do të jetë shuma e bazës së vlerësuar neto, sipas muajve,

pjesëtuar me numrin e muajve të periudhës së caktuar.

4. Baza e vlerësuar mujore, për efekt të llogaritjes së të ardhurave për barrëllindje, për gruan, e cila gjatë periudhës së shtatzënisë ka, së paku, një muaj sigurim, për rastet kur e drejta e përfitimit ka lindur, por përfituesja nuk ka pagë për gjatë 12 muajve të fundit, nga data e lindjes së të drejtës për pagesë, llogaritet duke bashkuar shumën e pagave faktike për muajt që është derdhur kontribut për sigurimet shoqërore, me shumën e pagave minimale, të përcaktuara për efekt të derdhjes së kontributit të sigurimit shoqëror, për muajt pa kontribut, pjesëtuar me 12. Baza e vlerësuar llogaritet në të njëjtën mënyrë edhe për rastet kur përfituesi është bashkëshorti, me kusht që ky i fundit të ketë jo më pak se 12 muaj sigurim, si dhe të jetë i siguruar, së paku, për një muaj nga data e lindjes së fëmijës.

5. Baza e vlerësuar mujore, për efekt të llogaritjes së të ardhurave për invaliditet të plotë ose të pjesshëm, të përhershëm, nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, për rastet kur e drejta e përfitimit ka lindur, por përfituesi nuk ka pagë për gjatë 12 muajve të vitit të fundit, nga data e lindjes së të drejtës për përfitim, llogaritet duke bashkuar shumën e pagave faktike, për muajt që është derdhur kontribut për sigurimet shoqërore, me shumën e pagave minimale, të përcaktuara për efekt të derdhjes së kontributit të sigurimit shoqëror, për muajt pa kontribut, pjesëtuar me 12.

6. Baza e vlerësuar mujore, për efekt të llogaritjes së të ardhurave për sëmundje, nga dita e 15 e raportit mjekësor e në vazhdim, për kompensim sëmundje dhe për llogaritjen e të ardhurave për paaftësi të përkohshme në punë, nga aksidentet ose sëmundjet profesionale, për rastet kur e drejta e përfitimit ka lindur, por përfituesi nuk ka pagë për disa muaj, gjatë 6 muajve të fundit, nga data e lindjes së të drejtës për pagesë, llogaritet duke bashkuar shumën e pagave faktike, për muajt që është derdhur kontribut për sigurimet shoqërore, me shumën e pagave minimale, të përcaktuara për efekt të derdhjes së kontributit të sigurimit shoqëror, për muajt pa kontribut, pjesëtuar me 6.

7. Baza e vlerësuar mujore neto, për llogaritjen e të ardhurave shtesë për perkujdesje ndaj invalidit, do të jetë shuma që del pasi nga baza e vlerësuar mesatare mujore, mbi të cilën është llogaritur



pensionit, zbritet tatimi mbi të ardhurat personale nga puna, shuma e kontributit të sigurimeve shoqërore, të sigurimit të kujdesit shëndetësor dhe të sigurimit suplementar të detyrueshëm, që zbritet nga paga e punonjësit, sipas dispozitave në fuqi, në momentin e lindjes të së drejtës për përfitim.

8. Baza e vlerësuar mujore, për efekt të llogaritjes së pensionit, për personat e vetëpunësuar në bujqësi, për personat që punojnë si punëtor shtëpie dhe për personat e vetëpunësuar në veprimtari tregtare apo shërbime ambulante, pavarësisht se kanë paguar kontribute, në bazë të tarifave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, do të jetë e barabartë me pagën minimale, të përcaktuar për efekt të pagesës së kontributeve, në vitin përkatës.

9. Instituti i Sigurimeve Shoqërore nxjerr rregullore të veçantë për llogaritjen dhe procedurën e indeksimit të bazës së vlerësuar për efekt të përfitimeve.

VIII. SHUMA BAZË E PËRFITIMEVE

1. Shuma bazë e përfitimit nga skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror, kur e drejta ka lindur deri në datën 31.12.2014, të jetë 12 264 (dymbëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë në muaj, kur përfituesi plotëson kushtet, si më poshtë:

a) për pension pleqërie, të ketë plotësuar më shumë se 17 vjet e gjashtë muaj si vjetërsi pune, në marrëdhënie me ish-ndërmarrjet ose institucionet shtetërore, apo si persona të siguruar pas vitit 1994;

b) për pension invaliditeti, të ketë plotësuar më shumë se gjysmën e periudhës minimale të sigurimit, të përcaktuar për këtë lloj pensioni, në marrëdhënie pune me ish-ndërmarrjet ose institucionet shtetërore, apo si persona të siguruar pas vitit 1994;

c) për nënën që ka lindur 6 e më shumë fëmijë, të cilët janë rritur mbi moshën 8 vjeç, të ketë plotësuar më shumë se 30 vite si vjetërsi pune në marrëdhënie me ish-ndërmarrjet ose institucionet shtetërore, apo si person i siguruar pas vitit 1994.

2. Shuma bazë e përfitimit të jetë 8 398 (tetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë në muaj, për personat që e drejta e përfitimeve u ka lindur deri në datën 31.12.2014, por që nuk e kanë plotësuar vjetërsinë e punës dhe periudhën e sigurimit, sipas përcaktimeve në pikën 1, të këtij kreu.

3. Shuma bazë mujore e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, për personat

që plotësojnë kushtet për përfitim, sipas dispozitave të ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nga data 1.1.2015 e në vazhdim, të jetë 12 264 (dymbëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë në muaj. Përfituesit e pensionit të parakohshëm kanë të drejtën e kompensimit të të ardhurave, sipas masës dhe kriterëve të përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 31.3.1994, “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse”, nr. 471, datë 15.7.1996, “Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm”, nr. 401, datë 21.6.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”, nr. 763, datë 27.12.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve”, nr. 415, datë 27.4.2009, “Për rritjen e pensioneve” dhe nr. 477, datë 30.6.2010, “Për rritjen e pensioneve”, me kusht që shuma e pensionit mujor plus kompensimi i të ardhurave të jetë 14 414 (katërmëdhjetë mijë e katërqind e katërmëdhjetë) lekë në muaj. Në rastet kur pensioni për vjetërsi shërbimi rezulton më i lartë se pensioni bazë dhe, bashkë me kompensimet, rezulton më i lartë se shuma e të ardhurave minimale prej 14 414 (katërmëdhjetë mijë e katërqind e katërmëdhjetë) lekë, kompensimet jepen pjesore, deri në plotësimin e kësaj shume.

4. Shuma bazë e pensionit, për personat që plotësojnë periudhën e sigurimit, sipas përcaktimeve në nenin 92, të ligjit, kur e drejta për përfitim lind nga data 1.1.2015 e në vazhdim, përfshi edhe këtë datë, të jetë 6 750 (gjashtë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë. Për llogaritjen e pensionit individual shuma bazë, e përcaktuar si më lart, shumëzohet me muajt e sigurimit, që personi ka arritur nëpërmjet derdhjes së kontributeve dhe pjesëtohet me muajt e sigurimit, të përcaktuara në nenin nr. 92, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar, që i referohet vitit të lindjes së të drejtës për pension. Për efekt të llogaritjes së shumës bazë individuale, konsiderohet një muaj i plotë vetëm kur periudha e sigurimit është mbi 15 ditë.



5. E ardhura për barrë lindje për gratë, të cilat periudhën e sigurimit për efekt të përfitimit të barrë lindjes e kanë si persona të vetëpunësuar në bujqësi, ose kanë më shumë se 6 muaj të periudhës së fundit të sigurimit, nga data e lindjes së të drejtës për pagesë, si persona të vetëpunësuar në bujqësi, duke filluar nga data 1.1.2015 e në vazhdim, të jetë 8 398 (tetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë në muaj.

6. Personat e vetëpunësuar në bujqësi janë të detyruar të paguajnë kontribute deri në plotësimin e moshës për pension, sipas nenit 92, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar. Përfshihen nga përfitimi i pensionit të reduktuar personat që në periudhën e përgjithshme të sigurimit kanë edhe vite të siguruar si persona të vetëpunësuar në bujqësi, nga viti 1994 e deri në mbushjen e moshës për përfitimin e pensionit.

IX. PAGESA E PËRFITIMEVE

1. Përfitimet afatshkurtra për sëmundje, barrë lindje dhe aksidente në punë e sëmundje profesionale, në favor të të punësuarit, llogariten nga punëdhënësi, ndërsa, për personat fizikë, nga strukturat lokale të sigurimeve shoqërore. Fondet për mbulimin e këtyre pagesave transferohen nga llogaritë e sigurimeve shoqërore në llogarinë e personit, juridik apo fizik, ose në llogarinë individuale të përfituesit, pranë bankave të nivelit të dytë, një herë në muaj, pas miratimit nga organet e sigurimeve shoqërore të listëpagesës. Procedura e kontrollit të listëpagesave dhe e miratimit të llogaritjeve përcaktohet me rregullore të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

2. Përfitimet mujore afatgjata u paguhen përfituesve nëpërmjet “Postës Shqiptare”, sh.a., subjekteve financiare profesionale, të pajisura me dokumentet përkatëse nga Banka e Shqipërisë dhe bankave të nivelit të dytë. Subjektet, që do të kryejnë shërbimin e pagesave, caktohen nga Këshilli Administrativ i Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Rregullat dhe procedurat e pagesës përcaktohen me marrëveshje ndërmjet palëve.

X. BASHKËPUNIMI NDËRMJET INSTITUCIONEVE

1. Marrëdhëniet administrative e financiare, ndërmjet Ministrisë së Financave, Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministrisë së Shëndetësisë, Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Bankës së Shqipërisë, Drejtorisë së

Përgjithshme të Tatimeve, bankave të nivelit të dytë dhe “Postës Shqiptare”, sh.a., rregullohen me akte nënligjore dhe me marrëveshje të përbashkëta.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rugor kontrollon edhe dokumentacionin që vërteton pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore nga personat e punësuar dhe të vetëpunësuar në veprimtari transporti. Kjo drejtori nuk do të ofrojë asnjë shërbim nëse drejtuesit e mjeteve nuk kanë shlyer detyrimet për sigurimet shoqërore dhe ato tatimore.

3. Subjektet juridike e fizike, që punësojnë invalidë, janë të detyruar të zbatojnë këshillat mjekësore lidhur me punën dhe zgjatjen e orarit të saj, të përcaktuara në vendimet e Komisioneve Mjekësore të Caktimit të Aftësisë për Punë, si dhe të njoftojnë zyrtarisht organet e sigurimeve shoqërore për plotësimin e kushteve të punës të invalidëve, pagën, si dhe për ndryshimin e tyre gjatë periudhës që i siguruari përfiton trajtim financiar si invalid. Procedurat dhe dokumentacioni përcaktohen me rregullore të ISSH-së.

XI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Personave, që kanë plotësuar moshën për pension pleqërie, sipas përcaktimeve në nenin 31, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, por që, deri më 31.12.2014 nuk plotësojnë periudhën e sigurimit, sipas përcaktimeve në nenin 92, dhe, ndërkohë, vazhdojnë sigurimin e detyrueshëm, pensioni do t’u llogaritet sipas dispozitave ligjore në fuqi, në momentin e ndërprerjes së sigurimit të detyrueshëm.

2. Personave, që kanë plotësuar kriteret për përfitimin e pensionit të plotë përpara datës 31.12.2014 dhe, ndërkohë, vazhdojnë sigurimin e detyrueshëm, pensioni do t’u llogaritet sipas dispozitave në fuqi, në momentin e plotësimit të kushteve për pension, ndërsa shtesa mbi pension, për shtyrjen e datës së daljes në pension, apo të ndërprerjes së tij, dhe rimarrjes në një datë të mëvonshme, sipas nenit 33, të ligjit, do të llogaritet sipas dispozitës në fuqi në vitin përkatës.

3. Vendimet nr. 1114, datë 30.7.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nr. 9136, datë 11.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e



Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nr. 10 383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shfuqizohen.

4. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të nxjerrin udhëzimet e nevojshme, në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.1.2015.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 2, datë 26.1.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 30.10.2014 mori në shqyrtim, në seancë plenare mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 47/15 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Mirela Sinani

SUBJEKT I INTERESUAR: Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën i vendimeve nr. 1714, datë 05.06.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; nr. 10-2009-648 (305), datë 16.07.2009 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe vendimin nr. 00-2012-1189, datë 25.05.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 49, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, si dhe nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkeses, që është shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkesja ka aplikuar për pozicionin e pedagoges së lëndës së sociologjisë pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, në vitin 2008, sipas njoftimit për shpalljen e vendit të lirë të punës. Sipas saj, ndonëse është përzgjedhur për lëndën që kishte konkurruar, asaj i është kërkuar të japë një lëndë tjetër që nuk kishte lidhje me formimin akademik. Në këto kushte, kërkesja, duke pretenduar se kontrata e punës është zgjidhur pa shkaqe të arsyeshme, pa respektuar afatin e njoftimit dhe procedurën, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me kërkesëpadi me objekt “*Detyrimin e palës së paditur për të shpërblyer dëmin e shkaktuar si pasojë e prishjes së kontratës së punës. Detyrimin e palës së paditur për të shpërblyer dëmin si pasojë e cenimit të nderit dhe personalitetit*”.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 1714, datë 05.06.2008, ka vendosur rrëzimin e padisë si të pambështetur në ligj dhe prova.

3. Kundër vendimit të mësipërm kërkesja ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Durrës, e cila, me vendimin nr. 305, datë 16.07.2009, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

4. Gjykata e Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim në dhomë këshillimi rekursin e kërkeses, me vendimin nr. 00-2012-1189, datë 25.05.2012, ka vendosur mospranimin me arsyetimin se nuk përmban shkaqe nga ato që përcakton neni 472 i KPC-së.

II

5. Kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 26.05.2014 duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, duke parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

5.1 Vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Gjykatës së Apelit Durrës janë



rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit dhe shprehje e arsytimit jologjik të fakteve dhe rrethanave objekt gjykimi. Gjykatat konsiderojnë si prova pohime të palës paditëse, të pabazuara në dokumente zyrtare dhe pa argumentuar lidhjen kronologjike midis tyre.

5.2 Gjykata e Apelit, ndonëse pranoi kërkesën për paraqitjen e dëshmitarëve dhe vendosi thirrjen e njërit prej tyre, në mungesë të një hetimi të plotë, la përsëri në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Po ashtu, kjo gjykatë ka ngatërruar arsyetimin për dëmin moral dhe ka shmangur problemin themelor, ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të shpifjes.

5.3 Vendimet janë, gjithashtu, haptazi të njëanshme, pasi nuk bazohen në provat e paraqitura dhe nuk u japin përgjigje pyetjeve të ngritura nga pala paditëse për sjelljen e punëmarrësit ndaj punëdhënësit, për shkaqet themelore që çuan në prishjen e kontratës së punës, duke cenuar të drejtën kushtetuese për punë dhe trajtim të barabartë.

5.4 Po ashtu, vendimet nuk janë të arsyetuara, fakt i cili ka cenuar të drejtën për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme.

5.5 Vendimi i Gjykatës së Lartë nuk ka riparuar shkeljet e proceseve gjyqësore të zhvilluara në shkallët e tjera dhe, për rrjedhojë, bie ndesh me garancitë e nenit 42 të Kushtetutës dhe nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së.

6. Subjekti i interesuar, universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës ka parashtruar me shkrim këto prapësime:

6.1 Vendimet e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe të Gjykatës së Apelit Durrës janë të bazuara në prova dhe në ligj. Ato janë rrjedhojë e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm gjyqësor të pretendimeve të paditëses, si dhe të provave të paraqitura nga palët në gjykim dhe të administruara në dosjen gjyqësore. Përfundimi i gjykatave se nuk ka ekzistuar ndonjë kontratë pune midis palëve ndërgjyqëse, është bazuar në interpretimin e dispozitave të Kodit të Punës.

6.2 Edhe pretendimi i kërkuarës mbi zhvillimin e një procesi të njëanshëm, në cenim të parimit të barazisë së armëve, është i pabazuar. Prova e ekspertimit teknik është analizuar nga gjykatat të cilat me të drejtë kanë arritur në përfundimin se nuk provohej ekzistenca e dëmit moral për sa kohë nuk ekzistonte kontratë individuale pune.

6.3 Po ashtu, i pabazuar është edhe pretendimi i kërkuarës për mosthirrjen e dëshmitarëve, për faktin se ajo nuk kishte kërkuar thirrjen e dëshmitarëve të tjerë përveç shtetases B.Z., e cila është thirrur dhe dëgjuar nga gjykata.

6.4 Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është i drejtë, pasi ankimi i paraqitur nga kërkuarësja nuk ishte në përputhje me shkaqet e parashikuara nga neni 472 i KPC-së.

III

A. Për legjitimitimin e kërkuarës

7. Kërkuarësja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të rregullimit kushtetues të neneve 131/f dhe 134/g të Kushtetutës, si dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga neni 30, pika 2 e ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”.

8. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata rithekson se kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 22, datë 22.07.2009 dhe nr. 31, datë 05.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Gjykata Kushtetuese rithekson se ajo ndërhyr në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve dhe të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata e analizon ligjin, faktin dhe rrethanën përkatëse në atë dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet 42 dhe 131, shkronja “P” të Kushtetutës, gjë e cila përbën juridiksionin e saj kushtetues. Detyra e gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimet nr. 14, datë 03.06.2009 dhe nr. 16, datë 19.04.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe



vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. (*shih vendimet nr. 3, datë 19.02.2013; nr. 31, datë 05.07.2011 dhe nr. 22, datë 22.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Bazuar në standardet e mësipërme, Gjykata konstaton se argumentet e kërkuës në mbështetje të parregullsive në dy shkallët e para të gjykimit kanë të bëjnë me çështje të interpretimit të ligjit, marrjes së provave dhe vlerësimit të tyre. Nisur nga natyra ligjore e këtyre pretendimeve, Gjykata çmon se zgjidhja e tyre nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues, por i përket juridiksionit të gjykatave të zakonshme.

11. Për rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundimin se kërkuësja nuk legjitimohet *ratione materiae* në lidhje me këto pretendime.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit nga Gjykata e Lartë

12. Kërkuësja ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk ka respektuar standardin e arsyetimit të vendimeve gjyqësore dhe po ashtu, nuk ka riparuar shkeljet e proceseve gjyqësore të zhvilluara në shkallët e tjera. Për rrjedhojë, sipas kërkuësës ky vendim bie ndesh me garancitë e nenit 42 të Kushtetutës dhe të neneve 6 dhe 13 të KEDNJ-së.

13. Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 25, datë 10.06.2011; nr. 8, datë 28.02.2012; nr. 3, datë 19.02.2013 dhe nr. 3, datë 23.01.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim (*shih vendimet nr. 23, datë 04.11.2008; nr. 7, datë 09.03.2009 dhe nr. 8, datë 16.03.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar

domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 3, datë 23.01.2014; nr. 3, datë 19.02.2013; nr. 20, datë 13.04.2012; nr. 8, datë 16.03.2011; nr. 38, datë 30.12.2010; nr. 7, datë 09.03.2009; nr. 23, datë 04.11.2008 dhe nr. 11, datë 02.04.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënie, përmban referencat në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se detyrimi për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit dhe se masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 25, datë 10.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Bazuar në parashikimet e normave procedurale që përcaktojnë elementet që duhet të përmbajë një vendim gjyqësor, si dhe bazuar në veçoritë e gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe në praktikën e saj, Gjykata çmon se në funksion të realizimit të vëzhgimit publik të administrimit të drejtësisë si dhe të koherencës së vendimit



gjyqësor, në mënyrë që përfundimi i procesit të vlerësimit të gjykatës të jetë i mbështetur, përmbajtja e vendimit përbën premisën për përmbushjen e standardit të arsyetimit të vendimit, i cili në këtë drejtim duhet të plotësojë dhe të përmbajë kriteret e përcaktuara nga dispozitat ligjore përkatëse dhe ato të zhvilluara nga jurisprudenca kushtetuese e konsoliduar (*shih vendimet nr. 3, datë 19.02.2013 dhe nr. 36, datë 25.07.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e rekursit, përmban në pjesën e tij hyrëse palët ndërgjyqëse, objektin e padisë, disponimet e gjykatave më të ulëta, ndërkohë që mungojnë shkaqet në bazë të të cilave kërkuuesja ka pretenduar ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe të Gjykatës së Apelit Durrës.

18. Nga përmbajtja e vendimit të Kolegjit Civil konstatohet se në pjesën arsyetuese ai pasqyron vetëm përfundimin se rekursi i paraqitur nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së, duke vendosur, në pjesën urdhëruese, mospranimin e tij. Në të tilla raste, Gjykata ka arsyetuar se nga leximi në tërësi i vendimit, rrjedha logjike e përdorur në vendim nuk rezulton e qartë dhe e kuptueshme dhe se argumentet e pjesës hyrëse nuk janë të lidhura logjikisht me pjesën arsyetuese dhe atë urdhëruese. Ato nuk formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, çka bën që përmbajtja dhe arsyetimi i tij të mos kenë një harmoni të brendshme. Për rrjedhojë, mungesa e paraqitjes së shkaqeve të parashtruara në rekurs, në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, nga jurisprudencë kushtetuese vlerësohet se përbën një të metë, të pakapërcyeshme, të përmbajtjes së vendimit dhe të arsyetimit të gjykatës.

19. Nisur nga sa u argumentua më sipër, si dhe bazuar në jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës në këtë drejtim, edhe në rastin konkret në shqyrtim, Gjykata vlerëson se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e rekursit, nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Mungesa e paraqitjes së shkaqeve të parashtruara në rekurs, në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), përbën një të metë, të pakapërcyeshme, të përmbajtjes së vendimit dhe të arsyetimit të gjykatës, duke krijuar dyshime edhe

për realizimin efektiv të së drejtës së aksesit në gjykatë nga ana e kërkueses.

20. Për rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimi i kërkueses për mosrespektimin e standardit kushtetues të arsyetimit është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “F”, dhe 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2012-1189, datë 25.5.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Sokol Berberi, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Vladimir Kristo

MENDIM PAKICE

Për arsye se nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, e çmoj të rëndësishme të shprehem me mendim pakice.

1. Kërkuuesja ka pretenduar cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, duke parashtruar argumente të cilat janë vlerësuar drejt nga shumica se kanë të bëjnë me çështje të interpretimit të ligjit, marrjes së provave dhe vlerësimit të tyre nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Për shkak të natyrës ligjore të pretendimeve, shumica arriti në përfundimin se kërkuuesja nuk legjitimohet *ratione materiae*, pasi zgjidhja e tyre nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues, por i përket juridiksionit të gjykatave të zakonshme.



2. Përfundimi i mësipërm rikonfirmon qëndrimin e konsoliduar se Gjykata Kushtetuese e analizon ligjin, faktin dhe rrethanën përkatëse në atë dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet 42 dhe 131, shkronja “f”, të Kushtetutës, gjë e cila përbën juridiksionin e saj kushtetues. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimet nr. 14, datë 03.06.2009 dhe nr. 16, datë 19.04.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

3. Nisur nga konstatimi i mësipërm dhe natyra e pretendimeve të parashtruara në kërkesë, shumica nuk duhet të kishte vijuar me analizën e pretendimit për cenimin e standardit të arsyetimit për dy arsye: *Së pari*, nga përmbajtja e kërkesës nuk konstatohet që kërkuësja të ketë pretenduar mosrespektimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nga Gjykata e Lartë për mungesë të shkaqeve në vendimin e mospranimit të rekursit. Në këtë kuptim, shumica ka analizuar kryesisht standardin kushtetues pa pasur asnjë pretendim nga ana e kërkuësës. *Së dyti*, edhe sikur të pranojmë se jo gjithmonë Gjykata duhet të ketë qëndrime vetëkufizuese, por mund të jetë disi aktiviste në qëndrimet e saj, në rastin konkret ky qëndrim është tërësisht kontradiktor. Nga njëra anë shumica i cilëson pretendimet e parashtruara nga kërkuësja si të natyrës ligjore dhe nuk konstaton mosrespektimin e ndonjërit prej aspekteve të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, nga ana tjetër arrin në përfundimin se mungesa e shkaqeve (ligjore dhe jo kushtetuese) në vendimin e mospranimit të rekursit krijon dyshimin serioz për cenimin e të drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë.

4. Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komple-

mentaritetit) (*shih vendimet nr. 4, datë 28.02.2006 dhe nr. 19, datë 02.04.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata duhet të investohet vetëm nëse konstaton shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor dhe nëse këto shkelje nuk janë konstatuar dhe riparuar nga Gjykata e Lartë. Në rast se Gjykata nuk arrin në një përfundim të tillë, pra që procesi i zhvilluar në të tria shkallët e gjykimit është i cënueshëm nga pikëpamja kushtetuese, ajo nuk mundet të shfuqizojë një vendim të Gjykatës së Lartë vetëm me arsyetimin se ai nuk përmban shkaqet e paraqitura në rekurs.

5. Ashtu siç jam shprehur edhe më parë në çështje të kësaj natyre, ky qëndrim i shumicës, megjithëse shërben për të ndrequr një mangësi në formulimin e vendimeve të mospranimit nga kolegjet e Gjykatës së Lartë, është i padobishëm dhe, mbi të gjitha, i jep vendimmarrjes të shumicës një karakter formal, ashtu siç edhe po ndodh në praktikë. Vendorsja nga Kolegji Civil e shkaqeve të rekursit dhe riparimi i të metës së cilësuar të pakapërcyeshme, nga njëra anë përbën riparim të vesit kushtetues të vendimit, por nga perspektiva e kërkuësës krijon pritshmëri iluzore, aspak reale dhe praktike, çka nuk duhet të jetë qëllimi i drejtësisë kushtetuese. Megjithatë, rikonfirmoj vlerësimin tim se kjo nuk e pengon shumicën që, edhe në rastet e mospranimit të kërkesës t'i tërheqë vërejtje Gjykatës së Lartë në mënyrë që të riparojë këto të meta në të ardhmen.

6. Në këtë kuptim, vlerësoj se qëndrimi i shumicës për shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë është i gabuar, pasi ndërhyrja jo vetëm ka qenë kryesisht, por në rastin konkret ajo ka tejkaluar qëndrimin e jurisprudence kushtetuese se Gjykata Kushtetuese ndërhyr kur përmes veprimeve të tyre gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

Anëtare: Vitore Tusha



VENDIM
Nr. 3, datë 26.1.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Bashkim Dedja kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
-----------------	----------	---	---

Sokol Berberi	anëtar i	“	“
---------------	----------	---	---

Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
----------------	-----------	---	---

Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
--------------	----------	---	---

Gani Dizdari	anëtar i	“	“
--------------	----------	---	---

Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
---------------	----------	---	---

Vitore Tusha	anëtare e	“	“
--------------	-----------	---	---

me sekretare Edmira Babaj, në datën 14.10.2014
mori në shqyrtim, në seancë plenare mbi bazë
dokumentesh, çështjen nr. 33/5 Akti, që i përket:

KËRKUES: Hanem Mohamed, Abdelaziz
Ibrahim

SUBJEKT I INTERESUAR: Ministria e
Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

OBJEKTI: Shfuqizimi, si të papajtueshme me
Kushtetutën, i vendimeve nr. 971, datë 20.07.2009
të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 00-2012-245,
datë 08.02.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së
Lartë (dhomë këshillimi).

Dërgimi i çështjes për shqyrtim në Gjykatën e
Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f, 134/g të
Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenet
27-30 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për
organizimin dhe funksionimin e Gjykatës
Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vitore Tusha,
mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të
kërkueses, që është shprehur për pranimin e
kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, që ka
kërkuar rrëzimin e kërkesës, dhe, pasi bisedoi
çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesit janë shtetas egjiptianë, të martuar
me katër fëmijë, ku më i vogli prej tyre ka shtetësi
shqiptare. Ata kanë qëndruar në Shqipëri për 13
vjet, periudhë gjatë së cilës kanë drejtuar

organizatat humanitare fetare “Miqësia” dhe
“Komiteti i Botës Islame”. Aktiviteti i këtyre
organizatave është përqendruar në shpërndarjen e
ndihmave ekonomike për jetimët, në organizimin e
kurseve dhe të aktiviteteve edukative, si dhe në
ndërtimin e objekteve të kultit.

2. Në vitin 2008, kërkuesit paraqitën kërkesë për
rinovimin e lejes së qëndrimit, e cila nuk u pranua,
por me shkresën nr. 960/1, datë 15.03.2008 të
Drejtorisë së Kufirit dhe Emigracionit, pranë
Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, bazuar në
urdhërin nr. 437 të datës 11.03.2008 të Ministrit të
Brendshëm, atyre u është komunikuar detyrimi për
t’u larguar nga territori i Republikës së Shqipërisë
brenda datës 31.03.2008 dhe për të mos hyrë deri
në datën 30.03.2018.

3. Kërkuesit, duke qenë se nuk kishin
informacion mbi aktin ku bazohej largimi i tyre dhe
as mbi provat mbi të cilin ai mbështetej, paraqitën
kërkesë në Ministrinë e Brendshme dhe në
Drejtorinë Rajonale e Kufirit dhe Emigracionit, por
nuk morën asnjë përgjigje.

4. Në këto kushte, kërkuesit i janë drejtuar
Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me
kërkesëpadi me objekt “Anulimin e urdhrit të
ministrit të Brendshëm...”, e cila, me vendimin nr.
7120, datë 25.07.2008, ka vendosur pranimin e
pjesëshëm të kërkesëpadisë dhe anulimin e urdhrit të
largimit nga territori i RSH -së.

5. Gjykata e Apelit Tiranë, mbi ankimin e
Ministrit të Brendshme, me vendimin nr. 971,
datë 20.07.2009, ka vendosur ndryshimin e
vendimit të mësipërm dhe rrëzimin e padisë.

6. Gjykata e Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim
rekursin e paraqitur nga kërkuesit, me vendimin nr.
00-2012-245, datë 08.02.2012, ka vendosur
mospranimin e tij në dhomë këshillimi.

II

7. **Kërkuesit** i janë drejtuar Gjykatës
Kushtetuese në datën 10.02.2014, duke pretenduar
shfuqizimin e vendimeve gjyqësore si rezultat i
cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor,
në aspektet e mëposhtme:

7.1 Procesi gjyqësor *nuk ka respektuar kërkesën
për t’u zhvilluar brenda afateve të arsyeshme* që përcakton
ligji nr. 8492, datë 27.05.1999 “Për të huajt”.
Ndonëse procesi gjyqësor duhet të përfundonte
brenda 45 ditëve, procesi në Gjykatën e Apelit ka
filluar 11 muaj pasi është shpallur vendimi i



Gjykatës së Shkallës së Parë, kurse procesi në Gjykatën e Lartë ka zgjatur 2 vjet.

7.2 Është cenuar *parimi i gjykatës së caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Lartë e kanë cilësuar aktin administrativ të Ministrit të Brendshëm si akt diskrecial, i cili nuk mund të ankimohet në gjykatë. Urdhri i Ministrit jo vetëm përbën tejkalim të diskrecionit, por është marrë në keqinterpretim të ligjit material dhe në kundërshtim me kërkesat e Kodit të Procedurave Administrative në lidhje me formën, arsyetimin, procedurat e njofumit dhe parimin e proporcionalitetit.

7.3 Është cenuar *parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Lartë kanë lënë në fuqi urdhrin e Ministrit të Brendshëm për largimin e kërkuesve në mungesë të provave që provonin bazueshmërinë e kësaj mase, duke e shkarkuar atë nga detyrimi për të vërtetuar ekzistencën e kushteve të refuzimit të lejes së qëndrimit. Edhe shkresa e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë referon në shkresën nr. 465/1, datë 28.02.2008 të Shërbimit Informativ Shtetëror, e cila jo vetëm nuk është administruar asnjëherë si provë në procesin gjyqësor, por i mungon arsyetimi, në kundërshtim me nenin 109/1 të KPA-së dhe nenet 4 dhe 5 të ligjit “Për të huajt”.

7.4 Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Lartë kanë cenuar edhe garancitë kushtetuese të parashikuara nga nenet 16 dhe 39 të Kushtetutës dhe detyrimet që burojnë nga sistemi i KEDNJ-së, pasi kanë urdhëruar, përmes një urdhri absurd dhe të pamotivuar, largimin nga RSH-ja të fëmijës më të vogël të kërkuesve, që gëzon shtetësi shqiptare.

7.5 Gjykata e Lartë, në referim të rasteve të përcaktuara nga neni 472 i KPC-së duhet të shprehë nëse në rastin konkret është shkelur ose jo ligji.

8. **Subjektet e interesuara, Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit**, kanë prapësuar me shkrim se pretendimet e kërkuesve janë të pabazuara, pasi urdhri i ministrit të Brendshëm për largimin e kërkuesve pas mbarimit të afatit të lejes së qëndrimit ka dalë në kushtet e përcaktuara nga neni 46, pika 4 i ligjit nr. 8492, datë 27.05.1999 “Për të huajt”. Urdhri është bazuar edhe në informacionin dhe propozimin me shkrim të Drejtorisë të Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pasi kjo e fundit, në përputhje me ligjin, është vënë në dijeni të

qëndrimit negativ nga Shërbimi Informativ Kombëtar për pajisjen e kërkuesve me leje qëndrimi.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

9. Gjykata sheh të arsyeshme të theksojë, paraprakisht, se pretendimet e kërkuesve ajo i vlerëson në drejtim të standardeve që imponon e drejta për një proces të rregullt ligjor dhe, në kontekstin e çështjes në shqyrtim, në aspektin e detyrimeve që u ngarkon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm respektimi i standardeve kushtetuese.

10. Gjykata ka tashmë një qëndrim të konsoliduar sipas të cilit interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete, nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 31, datë 05.07.2011; nr. 22, datë 22.07.2009 dhe nr. 14, datë 03.06.2009 të gjykatës kushtetuese*).

11. Bazuar në këtë standard dhe nisur nga natyra ligjore e argumenteve ku kërkuesit mbështetën pretendimet mbi cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj dhe të barazisë së armëve e kontradiktoritetit gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Apelit, Gjykata vlerëson se ato kanë të bëjë me vlerësimin e provave, mënyrën e interpretimit të fakteve dhe të zbatimit të ligjit nga ana e asaj gjykate. për rrjedhojë, gjykata çmon se këto pretendime nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues.

A. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

12. Sipas kërkuesve, ndonëse pretendimet e parashtruara në rekurs përfshihen në shkaqet e përcaktuara nga neni 472 i KPC-së, Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje këtyre pretendimeve.

13. Jurisprudenca kushtetuese ka theksuar se Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural



nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 35, datë 20.12.2005 dhe nr. 14, datë 17.04.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit) (*shih vendimet nr. 4, datë 28.02.2006; nr. 19, datë 02.04.2012; nr. 58, datë 24.12.2012; nr. 52, datë 02.12.2013 dhe nr. 3, datë 23.01.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Gjykimi kushtetues synon të vlerësojë nëse procesi, si i tërë, ka qenë i rregullt, duke u ndalur në ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të palëve në proces. Në këtë kuptim, Gjykata duhet të investohet vetëm nëse konstaton shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor dhe nëse këto shkelje nuk janë konstatuar e riparuar nga Gjykata e Lartë. Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*shih vendimet nr. 4, datë 28.02.2006 dhe nr. 19 datë 02.04.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata e ka vlerësuar si cenim të parimit për një proces të rregullt ligjor rastin kur gjykata e shkallës më të lartë, duke u bazuar në kompetencat që i jep Kodi i Procedurës, nuk ka plotësuar ose nuk ka korrigjuar mangësitë dhe gabimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta në plotësimin e standardeve dhe elementeve të një procesi të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 5, datë 25.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata ripohon se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr.*

8, datë 28.02.2012; nr. 8, datë 16.03.2011; nr. 25, datë 10.06.2011 dhe nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese).

17. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, penale apo civile, si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe, që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim (*shih vendimet nr. 8, datë 16.03.2011; nr. 23, datë 04.11.2008; nr. 11, datë 02.04.2008 dhe nr. 7, datë 09.03.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur apo të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimet nr. 20, datë 13.04.2012 dhe nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjithsesi, Gjykata e ka vlerësuar zbatimin e këtij parimi rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në



mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënë, përmban referencat në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura. Detyrimi i gjykatave për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit dhe masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 25, datë 10.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe, në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Në vlerësimin e Gjykatës nuk mjafton që arsyetimi të jetë formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Po në këtë drejtim, neni 310/1 i KPC-së parashikon se vendimi i gjykatës duhet të përmbajë hyrjen, pjesën përshkruuese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese, duke përcaktuar, në paragrafët e tjerë, elementet që duhet të përmenden në secilën prej këtyre pjesëve. Ndërsa për gjykimin në Gjykatën e Lartë, KPC-ja sanksionon se rekursi, ndër të tjera, duhet të përmbajë shkaqet për të cilat kërkohet prishja e vendimit, duke iu referuar normave ligjore mbi të cilat mbështetet (neni 475/ç) dhe se shqyrtimi i çështjes në kolegjet seleksionuese konsiston në një vlerësim të këtyre shkaqeve. Nëse rekursi bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që i lejon ligji, ai nuk pranohet dhe mospranimi i tij vendoset nga kolegji i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit (neni 480).

22. Nga parashikimet e dispozitave të KPC-së të lartpërmendura, si dhe bazuar në veçoritë e gjykimin në Gjykatën e Lartë dhe në praktikën e saj,

Gjykata çmon se në funksion të realizimit të vëzhgimit publik të administrimit të drejtësisë, si dhe të koherencës së vendimit gjyqësor, në mënyrë që përfundimi i procesit të vlerësimit të gjykatës të jetë i mbështetur, përmbajtja e vendimit përbën premisën për përmbushjen e standardit të arsyetimit të vendimit, i cili në këtë drejtim duhet të plotësojë dhe të përmbajë kriteret e përcaktuara nga dispozitat ligjore përkatëse dhe ato të elaboruara nga jurisprudenca kushtetuese e konsoliduar.

23. Në rastin konkret, Gjykata vëren se vendimi i mospranimit i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë përmban, në pjesën hyrëse të tij, objektin e padisë, disponimet e gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të apelit dhe faktin se kundër vendimit të kësaj të fundit ka paraqitur rekurs kërkuesi, por nuk përmban shkaqet që ai ka parashtruar në rekurs. Ndërsa në pjesën arsyetuese, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë është mjaftuar me përfundimin se rekursi i paraqitur nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së, duke vendosur, në pjesën urdhëruese, mospranimin e tij. Pra, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pavarësisht se në vendim nuk paraqet cilat janë shkaqet e kundërshtimit të vendimit të apelit, ka arritur të bëjë një proces vlerësimi të tyre (shkaqeve) nëpërmjet të cilit ka arritur në konkluzionin e shprehur në dispozitiv.

24. Nga leximi në tërësi i vendimit, Gjykata vlerëson se për shkakun e lartpërmendur, rrjedha logjike e përdorur në vendim nuk rezulton e qartë dhe e kuptueshme dhe se argumentet e pjesës hyrëse nuk janë të lidhura logjikisht me pjesën arsyetuese dhe atë urdhëruese. Ato nuk formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, çka bën që përmbajtja dhe arsyetimi i tij të mos kenë një harmoni të brendshme. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se mungesa e paraqitjes së shkaqeve të parashtruara në rekurs, në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, përbën një të metë, të pakapërcyeshme, të përmbajtjes së vendimit dhe të arsyetimit të gjykatës.

25. Gjykata, nisur edhe nga sa u argumentua më lart, çmon gjithashtu se, *prima facie*, mosparaqitja, në vendimin e Kolegjit Civil, të shkaqeve të parashtruara nga kërkuesi në rekurs, krijon dyshime edhe mbi cenimin e të drejtës së ankimit efektiv. Në këtë këndvështrim, pasqyrimi i shkaqeve të rekursit në pjesën hyrëse të vendimit të Kolegjit Seleksionues të Gjykatës së Lartë përbën një element të domosdoshëm dhe të rëndësishëm të tij,



i cili nuk ka thjesht karakter formal në përmbajtjen e vendimit gjyqësor.

26. Si përfundim, nisur nga sa më sipër, Gjykata çmon se vendimi i mospranimit të rekursit i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, objekt shqyrtimi, nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimeve gjyqësore. Mungesa e paraqitjes së shkaqeve të parashtruara në rekurs, në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), përbën një të metë, të pakapërcyeshme, të përmbajtjes së vendimit dhe të arsyetimit të gjykatës, duke krijuar dyshime edhe për realizimin efektiv të së drejtës së aksesit në gjykatë nga ana e kërkuarve.

27. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuarve në këtë aspekt është i bazuar dhe duhet pranuar.

B. Lidhur me pretendimin për shkeljen e të drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm

28. Kërkuarët kanë pretenduar cenimin e të drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i moszhvillimit të gjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, duke shkelur standardin e përcaktuar në nenin 42, pika 2, të Kushtetutës. Sipas tyre, procesi gjyqësor nuk ka përfunduar brenda afatit ligjor prej 45 ditësh, sepse procesi në Gjykatën e Apelit ka filluar 11 muaj pasi është shpallur vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, kurse procesi në Gjykatën e Lartë ka zgjatuar 2 vjet.

29. Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë, si dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor, në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregullt ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë të tillë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme. Kjo detyrë e gjykatave gjen rregullim në nenet 4 dhe 171/a të Kodit të Procedurës Civile, të cilat përcaktojnë se “*gjykata kujdeset për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor.....*” dhe “*gjykata ushtron të gjitha të drejtat e përcaktuara në këtë Kod, që janë të nevojshme për zhvillimin sa më të mirë të procesit gjyqësor. Gjykata cakton seancat dhe afatet brenda të cilave palët dhe personat e tjerë të thirrur prej saj duhet të kryejnë aktet procedurale dhe veprimet e tjera të kërkuara prej saj.*”

30. Po ashtu, Gjykata ka theksuar se për sa i përket sjelljes së autoriteteve, edhe pse kuadri procedural civil ka parashikuar parimin se iniciativat procedurale u takojnë palëve, kjo nuk i shkarkon gjykatat nga detyrimi për të siguruar një gjykim të shpejtë, siç kërkon neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6/1 i KEDNJ-së (*shih vendimin nr. 12, datë 05.03.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Për të vlerësuar pretendimet e individëve në lidhje me mosrespektimin nga gjykatat e zakonshme të kërkesës për gjykimin e çështjes brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata është mbështetur në mënyrë të vazhdueshme në kriteret e përcaktuara nga GJEDNJ-ja, të reflektuara më pas edhe në praktikën e saj të konsoliduar në këtë drejtim. Sipas këtyre kriterëve, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuarve, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun që sjell për kërkuarët kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit (*shih vendimin nr. 12, datë 05.03.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se ligji i zbatueshëm për zgjidhjen e çështjes në fjalë ka qenë ligji nr. 8492, datë 27.05.1999 “Për të huajt”. Në nenin 56 të këtij ligji parashikohej se kundër vendimit të refuzimit ose urdhrit të largimit të dhënë mbas shqyrtimit nga organi administrativ, mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 8 ditëve pas vendimit më të fundit administrativ, në rast se i huaji ka pasur qëndrim të ligjshëm jo më pak se një vit në RSH-së. Për çështjet e imigracionit, për të cilat bëhet ankim në gjykatë, zbatohen rregullat e parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile. Megjithatë, për vetë karakterin e këtyre llojeve çështjeve, shqyrtimi në të gjitha shkallët e gjykimit nuk mund të kalojë më shumë se 45 ditë (30 ditë gjykata e rrethit e 15 ditë gjykata e apelit).

33. Lidhur me periudhën e kohës që duhet marrë në konsideratë, Gjykata, referuar materialeve të dosjes gjyqësore, konstaton se procesi gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka përfunduar në datën 25.07.2008, kur gjykata ka vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim pala e paditur, Ministria e Brendshme. Kopje e ankimit i është njoftuar kërkuarve me dëftesën e komunikimit të datës 27.08.2008. Sipas ekstraktit të printuar nga faqja



elektronike e Gjykatës së Apelit (fq. 1 e fashikullit gjyqësor), rezulton se ankimi është regjistruar në datën 17.11.2008, kurse në datën 07.01.2009 shënohet: “...me urdhër të brendshëm të Kryetarit të Gjykatës së Apelit të datës 24.12.2008 ndryshohen trupat gjykues dhe çështjet rishpërndahen me short të ri elektronik...” Seanca e parë gjyqësore në Gjykatën e Apelit është zhvilluar në datën 25.06.2009 dhe procesi ka përfunduar në datën 20.07.2009, kur gjykata ka vendosur ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e kërkesë padisë. Në datën 20.08.2009, kërkuessit kanë depozituar rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila, pasi e ka shqyrtuar në dhomë këshillimi, në datën 08.02.2012, ka vendosur mospranimin e rekursit.

34. Për kompleksitetin e çështjes, Gjykata është shprehur se për vlerësimin e këtij elementi të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimet nr. 50, datë 22.11.2011; nr. 7, datë 27.02.2012 dhe nr. 43, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Në rastin konkret Gjykata konstaton se gjykimi i iniciuar prej kërkuessve, i cili ka pasur për objekt anulimin e aktit administrativ të Urdhrit të Ministrisë të Brendshme, është i natyrës administrative. Ky gjykim rregullohet nga dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative, të Kodit të Procedurës Civile mbi gjykimet e posaçme (nenet 324 e vijues) dhe ligji nr. 8492, datë 27.05.1999 “Për të huajt”.

36. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se, duke pasur parasysh natyrën e tij, gjykimi nuk paraqitet me natyrë komplekse. Në këto kushte, procedura e ndjekur për rihedhjen e shortit në Gjykatën e Apelit nuk duhet të bëhet shkak për zgjatjen e procesit tej afatit ligjor 15-ditor në Gjykatën e Apelit Tiranë, në referim të kërkesave të nenit 56 të ligjit “Për të huajt”.

37. Për sa i përket sjelljes së kërkuessve, referuar kronologjisë së proceseve gjyqësore, Gjykata vlerëson se paraqitja njëkohësisht e të dyja kërkesëpadive nuk ka shkaktuar vonesa të pajustificuara për zhvillimin e gjykimit. Përkundrazi, paraqitja e kërkesës për bashkimin e procedimeve dhe prania e vazhdueshme në të

gjitha seancat e zhvilluara tregojnë qartazi përpjekjet për të përshpejtuar procesin gjyqësor. Në këtë drejtim, Gjykata ripohon se, për sa i përket sjelljes së kërkuessve, përdorimi nga ana e tyre i të gjitha procedurave të parashikuara nga e drejta e brendshme, me qëllim sigurimin e mbrojtjes, nuk mund të përdoret si argument kundër tyre (*shih vendimet nr. 9, datë 1.04.2009 dhe nr. 12, datë 05.03.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Për sa i përket sjelljes së autoriteteve publike, nga materialet e administruara në dosjen gjyqësore rezulton se nga dita e paraqitjes së kërkesëpadisë (2008), deri në momentin e dhënies së vendimit të Gjykatës së Lartë (2012) kanë kaluar gati katër vjet. Gjykata, referuar sa më sipër, vlerëson se gjykatat e dy shkallëve të para, për shkak të mosmarrjes së masave të nevojshme dhe të domosdoshme për gjykimin brenda afatit ligjor 45 ditësh, nuk e kanë respektuar kërkesën për gjykimin e kësaj çështjeje në përputhje me standardin e procesit të rregullt ligjor të shqyrtimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm. Ndonëse cenimi i këtij standardi është pretenduar edhe në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë, kjo mangësi e procesit nuk është konstatuar dhe as është korrigjuar nga Gjykata e Lartë.

39. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se bazuar në llojin dhe natyrën e mosmarrëveshjes në gjykim, kërkuessve Hanem Mohamed dhe Abdulaziz Ibrahim iu është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e moszhvillimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

40. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuessve janë pjesërisht të bazuara dhe duhen pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës dhe neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

-Pranimin pjesërisht të kërkesës.



- Konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm.

- Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2012-245, datë 08.02.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Besnik Imeraj, Gani Dizdari

Anëtare kundër: Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha

MENDIM PARALEL

1. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka pranuar pjesërisht pretendimet e kërkuësve, Hanem Mohamed dhe Abdelaziz Ibrahim, dhe ka shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetutën vendimin nr. 00-2012-245, datë 08.02.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Pavarësisht se në qëndrimin përfundimtar pajtohem me vendimin e shumicës, cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor në procesin e zhvilluar në Gjykatë të Lartë e shoh edhe nën një këndvështrim tjetër.

2. Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë, lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit) (*shih vendimet nr. 4, datë 28.02.2006 dhe nr. 19, datë 02.04.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

3. Në këtë kuptim, Gjykata duhet të investohet vetëm nëse konstaton shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor dhe nëse këto shkelje nuk janë konstatuar e riparuar nga Gjykata e Lartë. Në rast se Gjykata nuk arrin në një përfundim të tillë, pra që procesi i zhvilluar në të tria shkallët e gjykimit është i cenueshëm nga pikëpamja kushtetuese, mendoj se ajo nuk mundet të

shfuqizojë një vendim të Gjykatës së Lartë, vetëm me arsyetimin se ai nuk përmban shkaqet e paraqitura në rekurs.

4. Lidhur me cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, sikurse jam shprehur edhe më parë (*shih mendimin paralel të vendimeve nr. 31, datë 10.07.2013; nr. 26, datë 24.06.2013; nr. 22, datë 20.05.2013 dhe nr. 3, datë 19.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese*), paraqitja formale (ndonëse e nevojshme) e pretendimeve në pjesën hyrëse të vendimit të Gjykatës së Lartë, në vlerësimin tim, megjithëse shërben për të ndrequr një mangësi në formulimin e vendimeve nga Kolegjet e Gjykatës së Lartë, mbetet skematike dhe e padobishme, pa vlerësuar atë që është më e rëndësishme në një vendim gjyqësor, pikërisht pjesën arsyetuese, e cila lidhet drejtpërdrejt me standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit. Një qëndrim i tillë i shumicës, mbi të gjitha, jo vetëm anashkalon jurisprudencën e kësaj Gjykate lidhur me unitetin dhe logjikën e vendimit në të gjitha elementet përbërëse të tij, por edhe nuk i shërben aspak kërkuësve, të cilët pretendimet e tyre për proces të parregullt ligjor i lidhin me cenimin e të drejtave të tyre kushtetuese.

5. Në vlerësimin tim, mungesa në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë e pjesës arsyetuese, pa nënvlerësuar aspak pjesët e tjera të tij të cilat së bashku përbëjnë një unitet, cenon në thelb standardin e arsyetimit të vendimit. Mungesa e kësaj pjese, nga ana tjetër, i heq mundësinë Gjykatës për të vlerësuar nga pikëpamja kushtetuese pretendimet e kërkuësve në raport me vendimmarrjen e gjykatës më të lartë të sistemit të juridiksionit të zakonshëm. Një qëndrim i kundërt, si në rastin në fjalë, jo vetëm bie ndesh me Kushtetutën dhe standardin e vendosur nga kjo Gjykatë, por, njëkohësisht, e bën vendimmarrjen e saj formale dhe aspak efektive.

6. Duke shkuar më tej, rasti konkret paraqet si veçori edhe ekzistencën e dy vendimeve të kundërta të gjykatave të faktit në zgjidhjen e konfliktit konkret. Personalisht jam shprehur mbi këtë rrethanë (*shih mendimin e pakicës të vendimit nr. 34, datë 12.07.2013*), por edhe Gjykata ka mbajtur qëndrim duke theksuar se roli i Gjykatës së Lartë, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për të pasur një rol aktiv që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar



efektivisht edhe në vendimarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta, veçanërisht në rastet kur dy gjykata u kanë dhënë përgjigje diametralisht të kundërta pretendimeve të kërkuarit. Nga kjo pikëpamje, Gjykata ka vlerësuar se në të tilla raste (që shqyrtohen rast pas rasti) kërkuar, duke mos marrë përgjigje për pretendimet e tij me natyrë kushtetuese për shkak të vendimit të mospranimin të rekursit, i cenohet e drejta e ankimit në kuptimin substancial, e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 3, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Për pasojë, mendoj se edhe në çështjen në shqyrtim, Gjykata e Lartë duhej të mbante qëndrim të shprehur qoftë edhe për të përmbushur detyrimin për unifikim të praktikës gjyqësore.

7. Gjithashtu vlerësoj se Gjykata e Lartë duhej t'i jepte përgjigje edhe pretendimit tjetër të kërkuarve lidhur me cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit. Kërkuar pretendojnë se gjykata e apelit ka lënë në fuqi urdhrin e ministrit të Brendshëm për largimin e tyre në mungesë të provave përkatëse, ndërsa vendimet gjyqësore referojnë në shkresën nr. 465/1, datë 28.02.2008 të Shërbimit Informativ Shtetëror, e cila nuk është administruar asnjëherë si provë në procesin gjyqësor, si dhe i mungon arsyetimi, në kundërshtim me nenin 109/1 të KPA-së dhe nenet 4-5 të ligjit "Për të huajt".

8. Në vështrim të jurisprudencës së GJEDNJ-së, mosinformimi i aplikantit (shtetas i huaj rezident në përputhje me ligjin) mbi shkakun e dëbimit nga autoritetet kombëtare si dhe vlerësimi thjesht formal i shkaqeve të dëbimit nga gjykatat, është vlerësuar si cenim i të drejtës së mbrojtjes, në drejtim të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit. Këto situata janë analizuar në raport me parashikimet e nenit 8 të KEDNJ-së "E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare", nenit 3 "Ndalimi i dëbimit të shtetasve" dhe nenit 4 "Ndalimi i dëbimit kolektiv të të huajve" të protokollit 4, si dhe nenit 1 "Garancitë procedurale në lidhje me dëbimin e të huajve" të Protokollit 7 të KEDNJ-së.

9. Në çështjet *C.G. and Others v. Bulgaria* (24/07/2008) dhe *Lupsa v. Romania* (08/09/2006), GJEDNJ-ja është shprehur se: "gjykatat kombëtare pretendimin e ekzekutivit se aplikanti përbehte rrezik për sigurinë kombëtare nuk ia nënshtruan një hetimi të kujdesshëm dhe të plotë" (Lupsa, § 41; *C.G. and Others*,

§ 44). Akti i dëbimit të tyre citon vetëm normat ligjore të zbatueshme dhe përmend faktin se aplikanti përbehte rrezik për sigurinë kombëtare. Një përfundim i tillë ishte bazuar në një informacion të paspecifikuar në përmbajtje të një dokumenti sekret të brendshëm. Në mungesë të njohurive mbi faktet kryesore që shërbyen si bazë për këtë vlerësim, aplikanti nuk ka qenë në gjendje të kundërshtojë çështjen në mënyrë të përshtatshme përpara Ministrit të Punëve të Brendshme dhe as në procedurat gjyqësore (*C.G. and Others*, § 45). Ndonëse aplikantit i është dhënë mundësia e kundërshtimit të aktit administrativ në gjykatë, ai nuk ka gëzuar minimumin e mbrojtjes kundër arbitraritetit (*Kaushal and Others v. Bulgaria*, 02/12/2010, § 27).

10. Edhe kur bëhet fjalë për çështjen e sigurisë kombëtare, konceptet e ligjshmërisë dhe të shtetit të së drejtës në një shoqëri demokratike kërkojnë që masat të cilat ndikojnë mbi të drejtat dhe liritë themelore duhet t'u nënshtrohen procedurave të kontradiktoritetit përpara një organi të pavarur kompetent për rishikimin e arsyeve të vendimit dhe të provave që lidhen me të edhe në ato raste kur zbatohen kufizime procedurale në përdorimin e materialit të klasifikuar (*Kaushal and Others v. Bulgaria*, 02/12/2010, § 29).

11. Nga sa më sipër, çmoj se vlerësimi i rrethanave të çështjes konkrete nën dritën e jurisprudencës së GJEDNJ-së, duke marrë në konsideratë edhe faktin se një prej fëmijëve të kërkuarve ka shtetësi shqiptare, si dhe në kuadër të garancive kushtetuese që duhet të gëzojnë shtetasit e huaj për të mos u dëbuar kolektivisht, passillte detyrimin për Gjykatën e Lartë që t'i jepte përgjigje edhe këtij pretendimi të kërkuarve.

12. Si përfundim, duke pasur parasysh edhe problematikën e shumta me natyrë ligjore në një çështje delikate si ajo në shqyrtim, cenimin e parimeve kushtetuese të lartpërmendura si dhe moszhvillimin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, sikurse ka konstatuar edhe shumica, jam i mendimit se Gjykata e Lartë, në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit, si dhe të kontrollit në respektimin e standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, duhet të mbante, në rastin konkret, qëndrim të shprehur, në respekt të së drejtës së aksesit në gjykatë dhe të parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë do të realizonte efektivisht edhe të drejtën



kushtetuese të kërkueseve për të pasur një ankim substancial në një gjykatë më të lartë, në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës.

13. Për rrjedhojë, në këtë këndvështrim, mendoj se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është rezultat i një procesi të parregullt ligjor dhe si i tillë duhej të shfuqizohej.

Anëtar: Vladimir Kristo

MENDIM PAKICE

Për arsye se nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, e çmoj të rëndësishme të shprehem me mendim pakice.

1. Nga rrethanat e çështjes rezulton se kërkuessit janë shtetas egjiptianë, rezident të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, të pajisur me leje qëndrimi dhe pune për një periudhë të caktuar kohore, në përputhje me kërkesat të ligjit nr. 8492, datë 27.05.1999 “Për të huajt”. Në fillim të vitit 2008, kur kërkuessit kanë paraqitur kërkesë për rinovimin e lejes së qëndrimit, u është komunikuar detyrimi për t’u larguar nga territori i Republikës së Shqipërisë brenda datës 31.03.2008 dhe për të mos hyrë në të deri në datën 30.03.2018.

2. Urdhri i largimit, pas ankimit administrativ, është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor në tria shkallët e gjykimit të zakonshëm. Gjithashtu, mbrojtësi i kërkuessve ka paraqitur një ankim individual edhe në Gjykatën Kushtetuese. Kjo e fundit ka pranuar pjesërisht kërkesën duke konstatuar cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor në drejtim të mosgarantimit të standardit të arsyetimit të vendimit nga Gjykata e Lartë, për shkak të mosreflektimit të shkaqeve të rekursit në vendimin e moskalimit dhe, po ashtu, në drejtim të mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm.

3. Nëse u referohemi garancive që gëzojnë shtetasit e huaj me qëndrim të rregullt në Shqipëri, konstatohet se fillimisht ato kanë qenë objekt rregullimi nga ligji nr. 8492, datë 27.05.1999 “Për të huajt” dhe aktualisht nga ligji nr. 108/2013. Kuadri ligjor reflekton standardet dhe garancitë e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), dhe në Direktivat e Bashkimit Evropian. Këto garanci janë të zbatueshme gjatë hyrjes, qëndrimit, largimit ose

dëbimit të shtetasve të huaj në përputhje me vendimet e autoriteteve të përcaktuara nga ligji. Për më tepër, kuadri ligjor parashikon të drejtën për të kundërshtuar urdhrin e largimit në rrugë administrative dhe gjyqësore.

4. Kërkuessit, duke qenë individë të cilët kërkojnë shfuqizimin e vendimeve gjyqësore pasi kanë shteruar mjetet juridike në dispozicion *prima facie* duket se legjitimohen *ratione personae, ratione tempore dhe ratione materiae*. Pavarësisht këtij konstatimi, nisur nga natyra e vendimeve gjyqësore objekt kundërshtimi, mendoj se shumica duhet të vlerësonte paraprakisht faktin nëse vendimet lidhur me hyrjen, qëndrimin dhe dëbimin e të huajve kanë të bëjnë me përcaktimin e të drejtave ose detyrimeve civile të tyre ose të një akuze penale kundër tyre, në kuptim të garancive kushtetuese të përcaktuara nga nenet 42 e të tjerë të Kushtetutës dhe neni 6§1 i KEDNJ-së, dhe, për rrjedhojë, nëse janë të zbatueshme në këto raste.

5. Në referim të jurisprndencës kushtetuese, teksti i Konventës dhe jurisprndenca e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) shërbejnë për të bërë interpretimin kushtetues dhe për të përcaktuar, rast pas rasti, kufijtë e të drejtave themelore kushtetuese. Jurisprndenca e GJEDNJ-së gëzon një status ekskluziv në sistemin tonë të brendshëm juridik, e cila është pranuar si e tillë për efekt të zbatimit të nenit 122 të Kushtetutës, po edhe të nenit 17/2 të saj, të cilët sjellin si detyrim që vendimet e GJEDNJ-së të zbatohen drejtpërsëdrejti. Me rastin e ratifikimit të KEDNJ-së, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, si përfaqësues i sovranitetit popullor, ka marrë përsipër detyrime të cilat janë të zbatueshme nga të gjitha organet shtetërore të Republikës së Shqipërisë, përfshirë gjykatat e të gjitha niveleve, pavarësisht llojit të tyre (*shih vendimin nr. 20, datë 01.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Çështjet e dëbimit të shtetasve të huaj rezidentë të ligjshëm janë bërë objekt shqyrtimi edhe nga GJEDNJ-ja. Në jurisprndencën e saj mbizotëron qëndrimi se të huajt rezidentë të ligjshëm në territorin e një shteti, në rastin e dëbimit, krahas mbrojtjes së përcaktuar në nenet 3, 8 dhe 13 të KEDNJ-së, përfitojnë edhe nga garancitë e veçanta të parashikuara në nenin 1 të Protokollit nr. 7, kur shteti në fjalë e ka ratifikuar atë (*shih vendimet Lupsa, §§ 51 - 52; Kaya kundër Rumanisë, nr. 33970/05, §§ 51 dhe 52, 12 tetor 2006,*



si dhe Bolat kundër Rusisë, nr. [14139/03](#), § 76, GJEDNJ 2006-XI).

7. Protokolli 7 i KEDNJ-së, në nenin 1 të tij përcakton se garancitë procedurale gjejnë zbatim për shtetas të huaj me qëndrim të rregullt në territorin e një shteti, që nuk mund të dëbohen, veçse në zbatim të një vendimi të marrë në përputhje me ligjin dhe duhet të kenë mundësi: (a) të parashtrijnë arsyet kundër dëbimit të tyre; (b) të kërkojnë shqyrtimin e çështjes së tyre; (c) të përfaqësohen për këto qëllime përpara autoritetit kompetent ose të një ose disa personave të caktuar nga ky autoritet. Një i huaj mund të dëbohet përpara ushtrimit të të drejtave të mësipërme, kur ky dëbim është i domosdoshëm në interes të rendit publik ose kur është bërë për arsye të sigurisë kombëtare.

8. Duke analizuar jurisprudencën e GJEDNJ-së mbi këtë kategori çështjesh konstatohet se deri në vitin 2000 nuk ishte marrë në shqyrtim zbatueshmëria e nenit 6§1 të KEDNJ-së në procedurat për dëbimin e të huajve. Ndërkohë, Komisioni ka shprehur vazhdimisht mendimin se vendimi që do të autorizojë një të huaj për të qëndruar në një vend në të cilin ai nuk është shtetas, nuk passjell përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, brenda kuptimit të nenit 6 § 1 të Konventës (*shih vendimet e Komisionit Uppal dhe Singh kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 2 maj 1979; *Bozano kundër Francës*, 15 maj 1984; *Urrutikoetxea kundër Francës*, 5 dhjetor 1996 dhe *Kareem kundër Suedisë*, 25 tetor 1996).

9. Duke filluar nga viti 2000, kur GJEDNJ-ja mori vendimin *Maaouia kundër Francës*, në vijimësi ajo rritet qëndrimin se vendimet lidhur me hyrjen, qëndrimin dhe dëbimin e të huajve nuk kanë të bëjnë me përcaktimin e të drejtave ose detyrimeve civile të dikujt ose të një akuze penale kundër aplikantit, në kuptim të nenit 6 § 1 të Konventës. Si pasojë, neni 6 § 1 nuk është i zbatueshëm në këto raste.

10. Në këto vendimmarrje GJEDNJ-ja rritet se konceptet e "të drejtave civile dhe detyrimeve" dhe "akuzës penale", nuk mund të interpretohen vetëm duke iu referuar ligjit të brendshëm të shtetit të paditur. Në disa raste GJEDNJ-ja ka pohuar parimin se këto koncepte janë "autonome", në kuptim të nenit 6 § 1 të Konventës (*shih, midis të tjerash, König kundër*

Gjermanisë, 28 qershor 1978, §§ 88-89; *Baraona kundër Portugalisë*, 8 korrik 1987, § 42 dhe *Malige kundër Francës*, 23 shtator 1998, § 34).

11. Në jurisprudencën e GJEDNJ-së konstatohet qëndrimi se dispozitat e Konventës duhet të interpretohet në dritën e të gjithë sistemit të Konventës, duke përfshirë Protokollet. Nisur nga ky qëndrim, GJEDNJ-ja vëren se neni 1 i Protokollit nr 7 është një instrument që u miratua më 22 nëntor 1984 dhe që përmban garancitë procedurale të zbatueshme për dëbimin e të huajve. Përveç kësaj, preambula e atij instrumenti i referohet nevojës për të ndërmarrë "hapa të mëtejshëm për të siguruar garancinë kolektive të të drejtave dhe lirive të caktuara me anë të Konventës ... ". Të marra së bashku, ato dispozita, sipas vlerësimit të GJEDNJ-së tregojnë se Shtetet ishin të vetëdijshme se neni 6§1 nuk zbatohet për procedurat për dëbimin e të huajve dhe dëshironin që të merrnin masa të veçanta në këtë sferë.

12. Përveç sa më sipër, edhe raporti shpjegues i Protokollit nr. 7, në seksionin mbi nenin 1, shprehet si më poshtë: "6 një i huaj, në mënyrë të ligjshme, në territorin e një shteti anëtar të Kësbillit të Evropës tashmë përfiton nga garancitë e caktuara kur ndaj tij është marrë një masë e dëbimit, sidomos ato të cilat janë përcaktuar nga nenet 3 (Ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues) dhe 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare), në lidhje me nenin 13 (E drejta për një ankim efektiv përpara një instance kombëtare) të Konventës, siç interpretohet nga Komisioni Evropian dhe Gjykata e të Drejtave të Njeriut ...Duke marrë në konsideratë të drejtat të cilat janë të njohura në këtë mënyrë në favor të të huajve, ky nen i Konventës është shtuar në mënyrë që të përballojë garanci minimale të personave të tillë në rastin e dëbimit nga territori i një Palë Kontraktuese. Shtimi i këtij neni mundëson që mbrojtja të jepet në ato raste të cilat nuk mbulojnë nga instrumente të tjera ndërkombëtare dhe lejon një mbrojtje të tillë që përfaqësohet në fushëveprimin e sistemit të kontrollit të parashikuar në ... Konventë".

13. GJEDNJ-ja mban qëndrimin se duke miratuar nenin 1 të Protokollit nr. 7, që përmban garanci në mënyrë specifike në lidhje me procedurat për dëbimin e të huajve, Shtetet shprehën qartë qëllimin e tyre për të mos përfshirë procedurat e tilla brenda fushës së nenit 6§1 të Konventës. Në dritën e sa më sipër, vlerësohet se procedurat për anulimin e urdhrit të dëbimit, të cilat formojnë lëndën e çështjeve objekt shqyrtimi, nuk kanë të bëjnë me përcaktimin e një "të drejte



civile" për qëllime të nenit 6 § 1. Fakti që urdhri i dëbimit rastësisht pati pasoja të mëdha në jetën private dhe familjare të kërkuesit ose mbi perspektivat e tij të punës, nuk mund të mjaftojë për të sjellë ato procedime brenda fushës së të drejtave civile të mbrojtura nga neni 6§1 i Konventës (*shih, mutatis mutandis, Neigel kundër Francës, 17 marsit 1997, §§ 43-44 dhe Maillard kundër Francës, 9 qershor 1998, §§ 39-41*).

14. Gjithashtu, GJEDNJ-ja rikonfirmon qëndrimin se urdhrat për dënimin e të huajve nga territori i një shteti nuk kanë të bëjnë as me përcaktimin e një akuze penale. Në këtë kuptim, ajo vëren se karakterizimi i tyre në kuadër të rendit juridik të brendshëm është i hapur ndaj interpretimeve të ndryshme. Në çdo rast, karakterizimi nga rendi vendor ligjor i dëbimit nuk mund, në vetvete, të jetë vendimtar për të përcaktuar nëse dënimi është kriminal në natyrë. Faktorë të tjerë, sidomos natyra e dënimit në fjalë, duhet të merren në konsideratë (*shih Tyler kundër Mbretërisë së Bashkuar, aplikimi nr. 21283/93, vendim i Komisionit, 5 prill 1994, DR 77, f. 81-86*).

15. Në përgjithësi, urdhrat e dëbimit nuk janë të klasifikuara si kriminale brenda Shteteve anëtare të Këshillit të Evropës. Urdhrra të tilla, të cilat në shumicën e shteteve mund edhe të bëhen nga autoritetet administrative, përbëjnë një masë të posaçme parandaluese për qëllime të kontrollit të emigracionit dhe nuk kanë të bëjnë me përcaktimin

e një akuze penale kundër ankuesit për qëllime të nenit 6 § 1. Fakti që ato janë vendosur në kontekstin e procedurave penale nuk mund të ndryshojë natyrën e tyre në thelb parandaluese. Procedurat për anulimin e masave të tilla nuk mund të konsiderohen se i përkasin sferës penale (*shih, mutatis mutandis, Renna kundër Francës, aplikimi nr. 32809/96, vendimi i Komisionit i datës 26 shkurt 1997, i paraportuar*).

16. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, nisur nga natyra e pretendimeve të parashtruara përpara Gjykatës Kushtetuese nga kërkuesit, vlerësoj se qëndrimi i mbajtur nga GJEDNJ-ja gjen zbatim edhe në rastin objekt shqyrtimi. Proceset të cilat lidhen me kontrollin e migracionit nuk përbëjnë çështje civile dhe as akuzë penale në vështirësi të përcaktimeve të nenit 6 të KEDNJ-së ose nenit 42 të Kushtetutës shqiptare. Aktet e dëbimit, të cilat kundërshtohen administrativisht dhe gjyqësisht, i përkasin të drejtës publike dhe përfaqësojnë ushtrimin e prerogativave të pushtetit publik.

17. Bazuar në arsyetimin e mësipërm, ndryshe nga sa ka vendosur shumica, mendoj se pretendimet e kërkuesve për cenimin e garancive të procesit të rregullt ligjor nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues dhe, për rrjedhojë, kërkesa duhet të ishte rrëzuar.

Anëtare: Vitore Tusha

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 220 lekë